

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7366 E hënë 27 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Nga LILIANA HOXHA

Shqiptarët vallëzojnë mbi të keqen e tyre

Sigjathet e adhurohet Skënderbeu Sgjatë valles së përjetshme aluqitative kundër vetes me kohën që ecën bashkë me historinë, ashtu po ndodh edhe me Enver Hoxhën... Vizion në faqen 20

Opinion **Ditës**

Nga SHABAN MURATI

Apologjia ruse dhe serbe për kasapin e Bosnjës

Dënimi i drejtë me burgim të përjetshëm në 22 nëntor i kasapit të Bosnjës, gjeneralit serb Ratko Mladić, nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për gjenocid dhe... Vizion në faqen 21

Opinion **Ditës**

Nga SHABAN MURATI

Apologjia ruse dhe serbe për kasapin e Bosnjës

Dënimi i drejtë me burgim të përjetshëm në 22 nëntor i kasapit të Bosnjës, gjeneralit serb Ratko Mladić, nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për gjenocid dhe... Vizion në faqen 21



Deputetët e LSI përplasen për vendimin e qeverisë "Rama"

Impiantet e mbetjeve, Vasili: Skandal, Koka: Keqardhje për çdo miop

Ish-ministri: Duan ta shohin Shqipërinë varrezë landfillësh

Djegia e mbetjeve ka përplasar dje, dy prej deputetëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ndërsa kryetari i Grupit Parlamentar, Petrit Vasili e ka cilësuar "skandal" atë të inceneratorëve të mbetjeve, ish-ministri i Mjedisit, Lefter Koka e quan këtë një vendim të drejtë të marrë nga qeveria "Rama". Kryetari i Grupit Parlamentar...

DETAJET E OPERACIONIT 24 ORESH TE POLICISE GREKE, U KAPEN 1.6 TONE HASHASH

SUPERAKSION ME SNAJPERA, KAPET GOMONIA SHQIPTARE

Pranga 10 pjesëtarëve të organizatës, 6 prej tyre shqiptarë. Plagoset një ndër skafistët. Ministri grek falënderon policinë. Berisha: Nga u nis skafi



(Në foto) Droga dhe sendet e sekuestruara gjatë operacionit të policisë greke

AXHENDA E FESTAVE

Kosovë-Shqipëri, sot mbledhja mes dy qeverive, firmosen 12 marrëveshje

VIZITA NE MEDVEGJE

Meta mesazh Serbisë: E ardhmja e dy popujve tanë është në BE, më shumë vëmendje

AKSIONI I VEÇANTE

Plagosi tre vetë në janar, ja si u prangos pas 11 muajsh arrati "i forti" i Vlorës

REPLIKA

Bashkim Asllani: Gjykatat, qëndrim diskriminues ndaj ish-ushtarakëve

REAGON E ËMA E PREZANTUES



Si u arrestua në Itali "Zoti i drogës", i dashuri i Viola Spiros

10 mënyrat për të parandaluar sëmundjet kardiovaskulare. Vetitë e arrave

Mjekja Vjola Ferra: Mos e neglizhoni check-up

"Cilat janë kategoritë që përfitojnë falas kontrollin, sa besojnë pacientët"

Nga VOLTIZA DURO

Check-up është një paketë cekzaminuese e ofruar falas në vendin tonë për grup moshat 35-70 vjeç, e cila ndihmon në kontrollin, identifikimin dhe diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve. Por në Shqipëri, ende shumë



pacientë nuk kanë besim mjaftueshëm të ky shërbim, e për pasojë ka raste kur pasi bëjnë kontrollin në shtet, i drejtohen edhe njëherë dyerve të privatit për siguri. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja...

Suplement Në faqen 12

TRAFIKU I DROGES OPERACIONET

Mjeti lundrues me fuqi motorike 350 kuaj dhe 12 metra e gjatë, fotot

Luftë me policinë greke, kapet gomonia me 1.6 tonë marijuanë

Aksion në ajër dhe det, në pranga 6 shqiptarë

Ina Allkanjari
Arbër Sulo

GREQI

Shkëmbim zjarri mes policisë e trafikantëve, motoskafe, helikopterë e snajperë, në këtë situatë pas mbi 24 orë ndjekje, policia greke ka arritur të kapë një gomone transoceanike të mbushur me 1.6 tonë marijuanë e cila ishte ngarkuar në Shqipëri. Gjatë këtij superaksioni ranë në pranga 10 pjesëtarë të organizatës ndërkombëtare të drogës, mes tyre 6 shqiptarë, përfshi dhe 3 drejtuesit e gomones. Një prej skafistëve u plagos gjatë shkëmbimit të zjarrit dhe u dërgua në spital. Vetë mediat e shtetit fqinj e quajtën këtë ngjarje si "Operacioni më i madh në historinë e policisë kufitare greke". Në një deklaratë zyrtare për shtyp pasditen e djeshme, policia greke dha detaje për kapjen e gomones me drogë të nisur nga Shqipëria. Gjatë deklaratës, policia greke theksoi se operacioni erdhi pas grumbullimit të informacionit mbi një organizatë ndërkombëtare të trafikut të drogës me mjete të shpejta ujore, e cila vepronte në mënyrë sistematike. Policia kishte informacion mbi emrat e pjesëtarëve të organizatës, veprimet e tyre, të dhëna mbi gomonen etj., dhe për këtë organizoi operacionin ku morën pjesë skafetë të policisë, avion i FRONTEX, helikopter dhe snajperistë.

OPERACIONI POLICOR

Organet policore dhe informative greke kishin siguruar informacion prej disa javësh për një grup të strukturuar ndërkombëtarë drogë në linjën Shqipëri-Greqi-Itali dhe kanë marrë informacion për nisjen e një ngarkese në orët e para të së premtes nga jugu i Himarës për në Greqi. Policia greke ka pritur mjetin lundrues në veri të Korfuzit me disa skafetë të saj, por është përballur çuditërisht me një gomone të gjatësisë 12 metra



Droga dhe sendet e sekuestruara gjatë operacionit



OPERACIONI POLICOR

Në ndjekje të trafikantëve janë vendosur skafetë e të paktën 5 porteve detare greke, një avion e më pas edhe një helikopter me forcat speciale amfibe dhe snajperistë. Operacioni ka përfunduar pikërisht pasditen e së shtunës pranë ishullit Xia në Athinë, ku gomonia është ndaluar nga pas shtënave nga snajperistët.



dhe me tre motorë nga 350 kuaj fuqi secili, ndër mjetet më të shpejta që ishte përballur ndonjëherë. Sapo kanë vënë re prezencën e policisë trafikantët janë drejtuar për në jug të Korfuzit. Në ndjekje të tyre janë vendosur skafetë e të paktën 5 porteve detare greke, një



Nga operacioni i policisë greke

Berisha



DENONCIMI

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka bërë një tjetër denonim. Duke i referuar qytetarit dixhital, Berisha poston denonimin e një ushtaraku të marinës nga Saranda, i cili shkruan: "Skafin e kapur dhe me 2 tonë e ca drogë nga forcat ushtarake Greke e konstatojnë vetëm radarat e Greqisë se radarat tanë janë "mësuar" dhe nuk i raportojnë më skafet, si ai që u nis dhe nga Himara".

GOMONIA

Policia greke ka pritur mjetin lundrues në veri të Korfuzit me disa skafetë të saj, por është përballur çuditërisht me një gomone të gjatësisë 12 metra dhe me tre motorë nga 350 kuaj fuqi secili, ndër mjetet më të shpejta që ishte përballur ndonjëherë.

avion FRONTEX e më pas edhe një helikopter me forcat speciale amfibe dhe snajperistë. Trafikantët hapën zjarr ndaj një skafi të policisë greke. Skafi i policisë iu kundërpërgjigj, por teksa kreu manovra, disa policë ranë në det duke u plagosur. Operacioni ka përfunduar pikërisht pasditen e së shtunës pranë ishullit Xia në Athinë, ku gomonia është ndaluar pas të shtënave nga

snajperistët. Policia greke ka ndaluar tre drejtuesit e saj, 2 shqiptarë e një italian, të cilët bashkë me gomonen janë transportuar drejt portit të Pireut. Nga gomonia është nxjerrë me barellë një nga skafistët për të cilin nuk dihet nëse është plagosur nga të shtënat e policisë greke

cioni vijoi me disa arrestime, konkretisht 4 shqiptarë të tjerë, 1 italian, 1 bullgar dhe 1 grek, ndërsa disa janë shpallur në kërkim duke e çuar numrin e të arrestuarve në 10 në total. Duhet thënë se trafikantët kanë hedhur në det gjatë ndjekjes edhe sasi të tjera droge, arme dhe materiale të tjera, megjithatë veç drogës dhe gomones me 3 motorë nga 350 kuaj fuqi secila, u sekuestrua gjatë kontrollave dhe një tjetër gomone me 4 motorë nga 350 kuaj fuqi secila. Trafikantëve u janë sekuestruar edhe 3 pistoletë ndërsa në gomone janë gjetur dhe sasi të madhe karburanti. Ndërkohë vijon bashkëpunimi me agjencitë të tjera europiane për zbardhjen e veprimit të këtyrë grupi kriminal. Ministri grek i Mbrojtjes, Panajotis Kurumplis dhe zv. ministri Nektaros Santorinos, i shprehën falënderimet e Shefit të Policisë Kufitare greke, Stamatios Rapti dhe efektivëve të kësaj policie. Sakaq policia greke po vijon kontrollimet dhe hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.



Faksimile e gazeta italiane
I arrestuari Valentin Selaj


Valentin Selaj e prezantuesja, çfarë shkruajnë gazetatat për ta

Si u arrestua në Itali "Zoti i drogës", i dashuri i Violës

Shisnin 10 kg kokainë vetëm brenda Firences

NGJARJA

Në maj të vitit 2015 prokuroria e Firences nisi hetimet mbi një grup kriminal, të cilët trafikonin drogë nga Amerika Latine në Holandë, nga porti i Roterdamit. Gjatë një viti e gjysmë hetimesh u kryen rreth 50 kontrolle dhe u sekuestruan sasi të konsiderueshme kokaine.



Viola Spiro me mamane

Reagon mamaja e moderatores Viola Spiro


Bie në pranga i dashuri i së bijës: Mjaft me sharje!

Brunilda Spiro, nëna e moderatores Viola Spiro ka reaguar në një status në "Facebook" pas lajmit se në Itali është arrestuar Valentin Selaj, i dashuri i vajzës së saj. Nëna e moderatores shprehet mjaft e irrituar me mediat për këtë ngjarje. "I kërkoj falje vajzës, që nuk mundem ta mbroj, kur e njoh shumë mirë dhe është vajza që do donte çdo nënë. E bukur natyrisht, inteligjente, e dashur dhe thjesht si gjithë njerëzit e kësaj kohe dhe bote, që po humb ekuilibrin, përpiqet të mbijetojë me punën e saj, me nder, pa u bërë pre e presioneve të asnjë drejtësi. I kërkoj falje që nuk ia mbroj dot dashurinë e saj, që po ia kthejnë në pazar lekësh, se dashuria e saj është dashuri. I kërkoj falje që nuk e mbroj dot dhe nuk jam pranë saj, sot që ka nevojë dhe nuk ia fshij dot lotët. Mjaft! Nuk rregullohet shoqëria shqiptare me fyerje, sharje dhe mllaf! Ju kërkoj falje që keni kaq mllaf për njëri-tjetrin, pasi nuk e drejtoni atë ndaj bosëve të vërtetë të nëpërkëmbjes tuaj. I kërkoj falje dhe atyre që do më shajnë, sepse nuk kanë kohë të ndalin kohën e mllafit të brendshëm, siç e thotë një filozof shqiptar: "Tanatosin" brenda tyre, por pa kthyer sytë nga vetja, shajnë dy të rinj 28-vjeçarë dhe një nënë, që do të mbrojnë fëmijën e vet deri në vdekje. Bëhuni të zgjuar dhe mos u mashtroni ditën me diell: "Bosët e drogës, janë gazetarët që u pasuruan me shitjen e fjalës së lirë, që kanë vila disa milionë euro, policët dhe politikanët", shkruan nëna e Viola Spiros, Brunilda.

Ina Allkanjari

ITALI

Idashuri i prezantueses shqiptare Viola Spiros është arrestuar në Itali nën akuzën trafik droge. I cilësuar si bos i shpërndarjes së kokainës në Firence, Valentin Selaj tashmë i duhet të përballet me drejtësinë italiane. Në një shkrim të gazetës italiane në versionin print "La Nazione", thuhet se Valentini ishte "Zoti i drogës" dhe kreu i një bande mjaft të fuqishme ndërkombëtare që sillte kokainë nga Amerika në Firence nëpërmjet Holandës. Në operacion morën pjesë forca të policisë italiane (të Firences) dhe asaj holandeze, pas hetimeve për një organizatë kriminale të specializuar në trafikun e drogës nga Holanda në Itali. Operacioni është zhvilluar në Firence, Amsterdam dhe Roterdam, ku hetuesit holandezë dhe policia e Firences kanë arrestuar 7 persona përgjegjës për trafikun ndërkombëtar të drogës, posedim të paligjshëm të armëve dhe pastrimit të parave. Gjatë arrestimit, raportohet se bandës i janë sekuestruar miliona euro dhe qindra kile kokainë dhe drogëra të tjera. Raportohet se vetëm në një javë ata qarkullonin 10 kile kokainë vetëm brenda qytetit të Firences. Operacioni është zhvilluar në zonën e Trevisos në Itali. Pas arrestimit nga policia të Valentini Selaj, një nga bosët e klanit shqiptar të kokainës, media lokale në Itali duke dhënë informacione mbi operacionin antidrogë ka shkruar edhe për bukurshen e ekranit shqiptar, Viola Spiro. "Ajo nuk ka asnjë faj. Përveç se është e bukur dhe e



I arrestuari Valentin Selaj me të dashurën Viola Spiro



Viola Spiro

ARRESTIMI I TË DASHURIT

Pas arrestimit të Valentini Selaj, e dashura e tij, prezantuesja e njohur Viola Spiro ka bërë një ndryshim në "Instagramin" e saj. Ajo ka vendosur të blloktojë të gjithë komentet, duke shmangur kështu të gjitha fjalët që i drejtohen asaj. Megjithatë kjo ngjarje nuk e ka ndalur atë që të postojë foto të tjera.

zgjedhura e Valentini Selaj, një nga bosët e klanit të shqiptarëve shkatërruar nga skuadra policore fiorentine me ndihmën e kolegëve holandezë", - ka shkruar media lokale në Itali për Spiro, i dashuri i të cilës është nënë pranga.

HETIMI

Në maj të vitit 2015 prokuroria e Firences nisi hetimet mbi një grup kriminal, të cilët trafikonin drogë nga Amerika Latine në Holandë, nga porti i Roterdamit. Gjatë një viti e gjysmë hetimesh u kryen rreth 50

kontrolle dhe u sekuestruan sasi të konsiderueshme kokaine. Për finalizimin e operacionit të koduar "ZZ", u angazhuan 150 forca policie të Trevisos, Brescias, Barit, Brindisit dhe Venezias. Në kuadër të këtij operacioni ranë në pranga 7 persona. Kjo organizatë drogë trafikonte kryesisht kokainë. Në kuadër të hetimeve në pranga ka përfunduar edhe një ish-futbollist i serie B, Giuliano Camporese nga Vittorio Veneto. Sipas raportimeve nga mediat e vendit fqinj, ish-futbollisti i

arrestuar kishte rolin e shpërndarësit të lëndës narkotike. Gjithashtu, janë arrestuar edhe Ermir Kola 31 vjeç, Klaudjan Koka 28 vjeç. Në kërkim janë, gjithashtu, edhe vëllezërit e "bos-it" shqiptar të grupit Selim Osmanit, Florian dhe Shkelzen, përkatësisht 26 dhe 36 vjeç. Hetimet kanë zbuluar se personat e sipërpërmendur kishin rolet e tyre, ndërsa bazën e kishin në Villorba, vend nga i cili ndiqnin shpërndarjen e sasive të mëdha të kokainës në provincën e Trevisos. Një nga krerët e grupit të trafikut mësohet të jetë Selim Osmani, një ish-punëtor, që një vit më parë kishte blerë edhe një mobilieri të cilën e kishte kthyer në bazë për shfshjen e drogës. (I arrestuar më herët, pasi iu gjetën 300 gramë kokainë në fabrikë). Rolin e transportuesve mësohet se e kanë pasur vëllezërit Babasi, të arrestuar në 2014-ën pasi në shtëpitë e tyre iu gjet me shumë se një kilogram kokainë. Gjatë operacionit u arrestua edhe Steven Trentin, që u kap me 20 gramë kokainë, si dhe Artan Ginaj.

KOSOVE-SHQIPERI MBLEDHJA

Më 28 Nëntor të dy kabinetet do të jenë në Vlorë për Festën e Pavarësisë

Sot, mbledhja Kosovë-Shqipëri, do të nënshkruhen 12 marrëveshje

Mbledhja e 2 qeverive shënon hapjen e "Vitet të Skënderbeut"

Darina Tanushi

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë pritet të nënshkruajnë sot, më 12 marrëveshje bashkëpunimi mes dy shteteve. Ashtu siç ishte planifikuar, sot pritet të nisë në qytetin e Korçës mbledhja e dy kabineteve, e cila mbahet në shenjë simbolike me rastin e Festës Kombëtare të Pavarësisë. Mbledhja do të zhvillohet në dy ditë. Kështu ditën e parë në Korçë mbledhja nis në orën 16:00 dhe do të zgjasë 90 minuta, do të mbyllet me një konferencë të përbashkët për shtyp të kryeministrave Rama e Haradinaj. Ministrat e kabineteve 'Rama' dhe 'Haradinaj', do të firmosin një memorandum bashkëpunimi mes Ministrive të Mjedisit, për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Mjedisit, një tjetër memorandum për bashkëpunimin në fushën e kulturës, marrëveshje dhe memorandum për bashkëpunimin për diasporën dhe një protokoll teknik mes dy Ministrive të Bujqësisë për njohjen bilaterale të certifikatave veterinarë për produktet shtazore mes dy vendeve. Gjithashtu, do të firmoset një memorandum mirëkuptimi mes agjencisë AIDA dhe homologes kosovare KIESA, për nxitjen e investimeve, një memorandum mirëkuptimi në fushën e energjisë elektrike mes dy Ministrive të Energjetikës, marrëveshje për njohjen e kontributeve shoqërore dhe marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrive të Jashtme, në kuadër të integritimit evropian. Ndërkohë ditën e dytë, të dy kabinetet do të zhvendosen në Vlorë, ku do të marrin pjesë edhe në festimet e 105-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Mëngjesin e datës 28, në ditën e festimeve të 105-vjetorit të Pavarësisë, 2 kabinetet qeveritare nisen drejt Vlorës ku në mesditë do të marrin pjesë në ceremoninë e ngritjes së Flamurit dhe do të kryejnë homazhe në monumentin e Atit të Pavarësisë, Ismail Qemal bej Vlorës, ceremoni që kryesohet nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Po në Vlorë, në Shtëpinë

Muze do të zhvillohet një aktivitet i përbashkët, ku do të shpallet dhe logo zyrtare e Vitit Mbarëkombëtar i Skënderbeut dhe ku 2 kryeministrat dhe presidenti Meta është parashikuar të mbajnë fjalime. Mbledhja e 2 qeverive shqiptare shënon dhe hapjen zyrtare të Vitit të Skënderbeut

me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar. Edhe kryeministri Edi Rama, e ka deklaruar gjatë vizitës së kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj se ky vit duhet të shërbejë për të bashkuar shqiptarët dhe si motiv për një të ardhme të ndritur. Kjo është mbledhja e katërt e

dy qeverive, që kur në pushtet ka ardhur Edi Rama. Mbledhja e parë u zhvillua në Prizren më 11 janar 2014, ku në atë kohë kryeministër i Kosovës ishte Hashim Thaçi. Mbledhja e dytë e përbashkët u zhvillua më 23 mars 2015, këtë herë në Tiranë, ku qeveria e Kosovës prezantohej me Isa Mustafën. Në 3 qershor 2016 dy qeveritë u mbledhën përsëri, për të tretën herë, këtë radhë në Prishtinë dhe nesër do të mbledhen në Korçë dhe kësaj herë kryeministri shqiptar Edi Rama do të ketë në krah homologun Ramush Haradinaj. Pas axhendës së ditës, dy delegacionet do të nisen për në Tiranë, ku do të marrin pjesë në pritjen që organizohet nga Presidenti i Republikës, me rastin e Festës Kombëtare. Edhe qeveria e Kosovës ka shpallur ditën e 28 Nëntorit, si festë kombëtare dhe ditën e shqiptarëve.



Takimi Rama-Haradinaj në Tiranë

FESTIMET

Pas axhendës së ditës së martë, dy delegacionet do të nisen për në Tiranë, ku do të marrin pjesë në pritjen që organizohet nga Presidenti i Republikës, me rastin e Festës Kombëtare. Edhe qeveria e Kosovës ka shpallur ditën e 28 Nëntorit, si festë kombëtare dhe ditën e shqiptarëve.

MARRËVESHJET

- Memorandum bashkëpunimi mes Ministrive të Mjedisit për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Mjedisit
- Memorandum për bashkëpunimin në fushën e kulturës
- Marrëveshje dhe memorandum për bashkëpunimin për diasporën
- Protokoll teknik mes dy Ministrive të Bujqësisë për njohjen bilaterale të certifikatave veterinarë për produktet shtazore mes dy vendeve.
- Memorandum mirëkuptimi mes agjencisë AIDA dhe homologes kosovare KIESA, për nxitjen e investimeve
- Memorandum mirëkuptimi në fushën e energjisë elektrike mes dy Ministrive të Energjetikës
- Marrëveshje për njohjen e kontributeve shoqërore
- Marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrive të Jashtme, në kuadër të integritimit evropian



Një nga mbledhjet e qeverive Kosovë-Shqipëri

Axhenda



MOTOJA E MBLEDHJES

Në axhendën e mbledhjes që do të mbahet sot, është zgjedhur motoja "Një tokë, një ëndërr, një popull". Dita e parë e mbledhjes që do të nisë në orën 16:00 të datës 27 dhe do të zgjasë 90 minuta, do të mbyllet me një konferencë të përbashkët për shtyp të kryeministrave Rama e Haradinaj.

Kryebashkiaku i Tiranës bashkëbisedon me të rinjtë e FRESH

Erion Veliaj: Duhet të mbetemi modestë edhe tani në qeveri

Kryebashkiaku Erion Veliaj, në cilësimin e anëtarit të Kuvendit të Partisë Socialiste bashkëbisedoi dje, me të rinjtë pjesëmarrës në "Samitin e Studentëve 2K18", organizuar nga FRESH. Veliaj u shpreh se në këto momente shoqëria jonë ka nevojë që të fitojë betejën me dijen, ndërsa apeloi për hapje. Kreu i Bashkisë theksoi se ka qenë gjithmonë kjo aftësi e PS për të pranuar të renë dhe për t'u hapur që e sollti këtë forcë politike në pushtet. "Ka njerëz që mendojnë se duke shtyrë tjetrin, ecin më lart vetë. Ajo që FRESH ka dëshmuar është, në fakt, që ne kur punojmë bashkë dhe ngremë lart njëri-tjetrin, ashtu fitojnë. Ndaj fitoi dhe PS, dhe prandaj do të vazhdojë të fitojë, sepse funksionon mbi logjikën që sidomos tani që



Këshilla

"Ajo që FRESH ka dëshmuar është, në fakt, që ne kur punojmë bashkë dhe ngremë lart njëri-tjetrin, ashtu fitojnë. Ndaj fitoi dhe PS, dhe prandaj do të vazhdojë të fitojë"

jemi në pushtet, ne duhet të hapemi akoma më shumë", - u shpreh Veliaj. "Logjika tipike në Shqipëri ka qenë që kur jemi në opozitë kemi nevojë për miletin, kështu që, hajde t'i bëjmë një hapje partisë. Ndërkohë që ajo që kërkon menguri dhe pjekuri është që: Kur je në pushtet dhe kur i ke të gjitha, pikë-

isht atëherë duhet të vazhdojë të ngelesh modest, pikërisht atëherë ke më nevojë më shumë se kurrë që të hapesh", - theksoi Veliaj. Kreu i Bashkisë deklaroi se sot më shumë se kurrë të jesh patriot i mirë për vendin është që të tregosh vlera të qytetarisë në jetën e përditshme.



Presidenti i Shqipërisë viziton komunën e Medvegjës, pritët nga serbë e shqiptarë

Meta mesazh Serbisë: E ardhmja e dy popujve tanë është në BE

"Politika t'u kushtojë më shumë vëmendje shqiptarëve"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje, në komunën e Medvegjës. Në pikën kufitare të Mutivodës, Presidenti Meta u prit nga kryetari i trupës koordinuese për Preshevën, Bujanocin e Medvegjën, z. Zoran Stanković, kryetari i komunës së Medvegjës, Nebojsa Arsić, nënkryetari e Komunës së Medvegjës, Leme Xhema, këshilltarë shqiptarë të kësaj komune si edhe nga dhjetëra shqiptarë. Në pritjen e ngrohtë që iu bë nga shqiptarët dhe drejtuesit vendorë, Presidenti Meta theksoi ndër të tjera: "Kjo është një ditë shumë e bukur për mua. Ndihej e emocionuar që ndodhem sot pranë jush. Politika duhet t'iu kushtojë më shumë vëmendje shqiptarëve këtu dhe këtyre zonave. Shpresoj që kjo vizitë e imja të kontribuojë në këtë drejtim. Nga Medvegja dua të theksoj se e ardhmja e popujve tanë dhe e të gjithë rajonit është në Bashkimin Europian dhe kjo mund të realizohet vetëm duke bashkëpunuar me ngushtë me njëri-tjetrin".



Presidenti i Republikës Ilir Meta dje, në komunën e Medvegjës

DEKORATA

Duke i uruar mirëseardhjen dhe duke falënderuar për vëmendjen, përfaqësuesi i diasporës shqiptare të Medvegjës, z. Fadil Selmani, në emër të tyre, i ka dhënë Presidentit Meta një pllakatë falënderimi dhe monografinë e shoqatës humanitare "Medvegja".

MEDIA SERBE

Edhe mediat serbe i kanë bërë jehonë vizitës së Presidentit shqiptar Ilir Meta, dje, në Medvegjë. "Pozicioni ynë është i qartë, kur një person vjen në vendin tonë ka mundësi të caktuara për të ndihmuar njerëzit e tjerë që jetojnë edhe në vendin tonë, për të zgjidhur së bashku këto çështje", -tha Presidenti i Trupit Koordinues për Serbinë Jugore.



PRESIDENTI

Ndihej e emocionuar që ndodhem sot pranë jush. Politika duhet t'iu kushtojë më shumë vëmendje shqiptarëve këtu dhe këtyre zonave. Shpresoj që kjo vizitë e imja të kontribuojë në këtë drejtim. Nga Medvegja dua të theksoj se e ardhmja e popujve tanë dhe e të gjithë rajonit është në Bashkimin Europian dhe kjo mund të realizohet vetëm duke bashkëpunuar me ngushtë me njëri-tjetrin".



Kthehet anija "Oriku" nga deti Egje

Olta Xhaçka: Një mijë jetë të shpëtuar nga dora e shqiptarit

Anija "Oriku" pjesë e Flotës Detare Shqiptare është kthyer në atdhe pas një viti qëndrimi në detin Egje, pjesë e operacionit të NATO-s "AEGEAN SEA". Nga 21 nëntori i vitit të kaluar e deri tani, gjashtë ekuipazhet e anijes "Oriku", P-132, kanë marrë pjesë në dhjetëra operacione në detin Egje, në kuadër të përpjekjeve ndërkombëtare për të ndaluar trafikimin ilegal dhe migrimin në këtë rajon të trazuar. Rezultat i këtyre operacioneve është dhënia e ndihmës dhe shpëtimi i rreth 1 mijë personave të moshave, gjinive e shtetësisë të ndryshme, siriane, nigeriane, irakiane, somaleze, jemenase, kongoleze etj., të cilat nga brigjet e Turqisë do kalonin për në brigjet greke apo vende të tjera të BE. Në ceremoninë e organizuar në Portin e Durrësit, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka tha se, prania e anijes "Oriku" në detin Egje është shembulli më i mirë i lënies pas të çdo retorike, kur vjen fjala për të shërbyer në një mision NATO. "Dhe çfarë suksesi! Një mijë jetë të shpëtuar gjatë këtij viti, një mijë njerëz që falënderojnë flamurin e kuq me shqiponjën dykrenore. Falënderojnë e kujtojnë të gjithë ju, ushtarakë të Forcës sonë Detare, se u zgjatën dorën e shpresës dhe dritën e jetës, aty ku terrori i luftës dhe mungesa e së ardhmes, detyroi një kolonë të madhe njerëzore drejt eksodit larg nga Siria e Iraku", -tha ministrja në fjalën e saj. Ajo ka vlerësuar kontributin e të gjithë efektiveve shqiptarë në të gjitha misionet paqeruajtëse ku Shqipëria merr pjesë, siç janë ato në Afganistan e Kosovë, të cilat ministrja Xhaçka i vizitoi gjatë javës që kaloi. Shqipëria do të zgjasë me një vit qëndrimin e saj në detin Egje dhe së shpejti drejt operacionit do të nisët anija "Butrinti" me 17 anëtarë të ekuipazhit.

Kritikat për vetingun, të bëhen nga shqiptarë

Ish-ministri, Shfaqet Muçi: Roli i ONM-së i kufizuar, nuk njohin Shqipërinë

Roli i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, që do të zëvendësojë organet e vetingut do të kushtëzohet nga fakti se anëtarët e kësaj trupe nuk njohin realitetin shqiptar. Në një analizë të procesit të vetingut, ish-ministri i Drejtësisë Shfaqet Muçi tha dje, për tv Scan se këta juristë do të kushtëzohen nga materialet e përkthyer që do t'u vihen në dispozicion dhe se kontakti i drejtpërdrejtë me sistemin do të jetë i mjaft i kufizuar për ta. "Tani unë po them një mendim që ndoshta do ma kundërshtojnë shumë persona, por unë kam më



shumë besim të shqiptarët se sa tek të huajt. Jo se të huajt nuk janë më të aftë se ne, por nuk e njohin situatën në Shqipëri. Në fund të fundit ata nuk dinë shqip, dhe ata që ua rekomandojnë problemet janë shqiptarët, kështu

ndërkombëtarët do i marrin të përkthyer. Sa do që të verifikojnë, në fund të fundit ata që dominojnë janë shqiptarët. Roli i deciziv e ka i zoti i shtetësisë, nuk e ka i huaji. Të huajt monitorojnë, japin mendimet e tyre dhe organet vendimmarëse të jenë organet shqiptare. Në fund të fundit ne nuk kemi shtet vasal, jemi shtet sovran", shprehet ish-ministri. Muçi thotë se procesi nuk ka arritur të plotësohet në asnjë prej komponentëve të tij: legjislacioni, kostot financiare dhe kapacitetin profesional të personave që do rivlerësojnë gjyqtarët e prokurorët.

këpunim, tha Presidenti i Shqipërisë. "Vetë fakti se ne jemi këtu do të thotë që jemi pozitivë dhe prandaj jemi këtu, të japim një mesazh të qartë se jemi për të punuar së bashku", -tha Meta. Ai shton se është i kënaqur me mbërritjen në Medvegjë, ku u përshëndet në serbisht. "Jam shumë i kënaqur që sot mund të jap një mesazh pune dhe bashkëpunimi të përbashkët, sepse ne jemi në një

epokë të re në bashkëpunimin midis dy vendeve të Serbisë dhe Shqipërisë, si dhe popullit", -tha Meta. Në komunë, sipas regjistrimit të fundit të mbikëqyrtur nga OSBE-ja, jetojnë 7,000 serbë dhe 520 shqiptarë, nuk ka ndarje sipas kombësisë. Kryetari Nebojsa Arsić theksoi se Medvegja është një shembull i shkëlqyeshëm i marrëdhënieve të mira ndëretnike. "Ne do të konfir-

mojmë atë që unë vazhdimisht dhe me krenari them se Medvegja është një shembull i shkëlqyeshëm i marrëdhënieve multietnike jo vetëm midis serbëve dhe shqiptarëve, por edhe midis serbëve dhe pakicave të tjera kombëtare", -tha Arsić. Vizita në komunën e Medvegjës e Presidentit të Shqipërisë përfundon të hënën në mëngjes, duke vizituar shkollën fillore në fshatin Tupalka.

OPOZITA NISMA

Ish-kryetarja e Kuvendit: Nuk jam tërhequr nga politika

Jozefina Topalli: Vendi është në udhëkryq, në Kuvend luhet teatër

Ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli vijon ta ndjekë politikën çdo ditë, edhe pse tashmë nuk është pjesë e parlamentit. "Vendi ynë është në udhëkryq. Shoh që varfëria është shumëfishuar. Zhvillimet e fundit janë dramatike për vendin tonë, jo se janë të reja dhe jo se nuk i dim, por shpërthimi i tyre ka bërë që të humbasë shpresën", u shpreh ajo në një intervistë për "Ora News". Maxhoranca dhe opozita janë bashkë dhe në parlament po luajnë një teatër të neveritshëm, -thotë Topalli. E pyetur se a do t'i kthehet ajo politikës aktive, Topalli shprehet: "Kam ndalur hapin për arsye të zhvillimeve që dihen, por nuk jam fare indiferente ndaj politikës. E ndjek çdo minutë, 24 në 24 orë. Ndoshta di më shumë për shkak të pozicioneve që kam pasur dhe



Ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli

kuptoj edhe më mirë se çfarë po ndodh. Unë dyshoj shumë se ata janë të gjithë bashkë dhe në parlament luajnë një teatër gati të neveritshëm". "Sigurisht që më mungon foltorja dhe jo ajo foltoze që

është sot në parlament. Kjo nuk do të thotë se unë jam tërhequr nga politika", -u shpreh Topalli. Ajo ka qenë mjaft kritike me mënyrën se si po drejton kryetari i PD-së, Lulzim Basha. Topalli nuk u

bë më pjesë e listës së deputetëve të PD-së në këtë legjislaturë dhe kjo e pozicionoi atë në kampin e kundërshtarëve. Mëngjesin e djeshëm ajo u surprizua nga një grup të rinj, të quytetit të Shkodrës, të cilët i uruan ditëlindjen e 54-t. Në mbishkrimin e tortës së ditëlindjes ata kishin shkruar: "Edhe 100 vite të tjera kontribut për atdhe", ndërsa buqeta e luleve ishte me trëndafila të bardhë dhe blu, simbol i Partisë Demokratike. E emocionuar nga kjo surprizë që i nisi ditën, Topalli shprehu falënderime për të rinjtë, që vijojnë të jenë një përkrahje e madhe për të.




Gjatë një seance parlamentare

10 deputetë demokratë, mes tyre edhe kryetari i partisë, Basha propozojnë rezolutë në Kuvend

PD: Jo amnisti për krimet brenda familjes

Vokshi: Të reagojmë ndaj dhunës qeveritare që po përhapet si epidemi

Partia Demokratike propozon përjashtimin nga amnistia të të gjithë atyre që janë dënuar për krime brenda familjes. 10 deputetë të PD-së, mes të cilëve edhe kreu i partisë, Lulzim Basha kanë firmosur një rezolutë, të cilën e kanë depozituar në Kuvend. Me nismën e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë do të zhvillohet në 4 dhjetor një mocion me debat për masat kundër dhunës në familje. Pjesë e këtij debati është edhe kjo rezolutë e propozuar nga Partia Demokratike me nisma konkrete që, nëse zbatohen nga institucione të përgjegjëse, do të reduktojnë ndjeshëm dhunën në familje. Debatit i 4 dhjetorit përkon me Ditët Ndërkombëtare të Sensibilizimit Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 25 nëntor-10 dhjetor. "Këto janë ditët, kur ne nuk duhet të heshtim. Këto janë ditët për të reaguuar njëzëri kundër dhunës që



Faksimile e 10 deputetëve të PD-së që kanë firmosur rezolutën

veritare, që fillon nga kryeministri edhe përhapet si epidemi në të gjitha format e saj në çdo institucion!" - u shpreh Albana Vokshi, një nga hartueset e rezolutës së paraqitur nga Partia Demokratike. Vokshi vë në dukje se "Nëpërmjet propagandës qeveria po tenton të mbulojë dëshimin spektakolar të saj për të mbrojtur gratë e fëmijët, pa kërkuar ndjesë se në 4 vite qeverisje

nuk arritën të mbrojnë asnjë viktimë të dhunës në familje, një prej tyre edhe gjykatëse". Një aspekt tjetër i dështimit të qeverisë, siç shprehet Vokshi në një status në "Facebook", është mbrojtja e fëmijëve dhe grave, që trafikohen dhe shfrytëzohen prej 5 vitesh në fushat me kanabis dhe në landfillet e plehrave. "Qeveria ka dështuar të vendosë në funksionim mekanizmin për



Deputetja Albana Vokshi

mbrojtjen e grave nga dhuna, sepse policinë dhe institucionet i vuri në shërbim të trafikut të drogës dhe bandave kriminale"- theksoi Albana Vokshi. Rezoluta e PD shpreh shqetësimin se: "Qeveria dhe pushteti vendor kanë dështuar të marrin masat e duhura dhe të nevojshme, për reduktimin dhe parandalimin e dhunës në familje, si dhe për bashkërendimin e punës midis tyre për mbrojtjen e vik-

timave të dhunës në familje. Qeveria s'ka ndërthurur asnjë mekanizëm efikas për parandalimin e dhunës në familje". Prandaj, rezoluta e PD kërkon: "Mbiqëqyrje të fortë parlamentare dhe trajtim të denoncimeve për dhunën në familje; Brenda 15 ditëve Kuvendi krijon komision të posaçëm për trajtimin ligjor të fenomenit". Më tej në rezolutë propozohet që "60 ditëve qeveria të bëjë analizën, të

paraqesë të dhënat, të krijojë regjistrin kombëtar për dhunën në familje". Të tjera pika janë: "përcaktimi me ligj të një strukture të vetme përgjegjëse me qëllim parandalimin e dhunës dhe garantimin e mbrojtjes së viktimave; përjashtimi me ligj nga amnistia dhe nga rrethanat lehtësuese gjatë gjyqimit për krimet në familje; rishikimi për masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje për moslejimin e bashkëjetësës në një mjedis të dhunuesit dhe viktimës". PD propozon edhe rishikimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimës dhe mjeteve të nevojshme për rastet e rrezikut për jetën, duke mirë përcaktuar detyrimet e Policisë së Shtetit, përcaktimin e personave përgjegjës që marrin përsipër të mbajnë nën kontroll dhunuesin, si dhe aplikimin gjerësisht të mbikëqyrjes elektronike për rastin e dhunuesve brenda familjes.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ
 Përmbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Pylë me sipërfaqe totale 551 m², me Nr.Pasurie 62936, Vullmi 9, Faqe 157, Zona Kadestrale 2460, e ndodhur në Lincë, Tiranë", e lene kotalateral per garantimin e kredite, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditort ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1.202.701,28 (nje milion e dyqind e dy mije e shtatëqind e nje qike rrezeite e tete)Leke.
 Cmimi filluesar me te cilin fillon ankandi është ne shumen 5.730.400(pese milion e shtatëqind e tridhjetë mije e katërqind)Leke, e konvertuar ne monedhen Euro sipas kursit filleter te kombëtarit vektor te Bankes se Shqiptare ne daten 02.10.2017(1 euro = 133.76 leke), ne shumen 42840(dyzetë e dy mije e shtatëqind e dyzetë)Euro.
 Ankandi zhvillohet ne date 06.12.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33,Tiranë, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyraparbarimit.com.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ
 Përmbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e dures e pasurise se paluajtshme "Apartamenti", me Nr.Pasurie 53304-B, Zona Kadestrale 8513, Vot.14, Fq.69, me sipërfaqe 52.02 m², te ndodhur ne P.Soraa/17, Pall.978/1, Shk.1, Ap.8, Dures, e lene kotalateral per garantimin e kredite, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditort ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1.961.130,58(nje milion e nentëqind e gjashtëdhjetë e nje mije e neqind e tridhjetë qike pesëdhjetë e tete)Leke dhe 33,60(tridhjetë e tre qike gjashtë)Euro.
 Cmimi me te cilin fillon ankandi i dute është ne vleren 15680(pesëmbëdhjetë mije e gjashtëqind e tetëdhjetë)Euro.
 Ankandi zhvillohet ne date 05.12.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33 Tiranë, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyraparbarimit.com.

SHPLLJE ANKANDI
 Shoqëria Përmbarimore "Enforcement Group" sh.p.k. shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të llojit Ndërtëse, me Nr. 213/33-ND, vullmi 17, faqe 150, ZK 3976, me sipërfaqe 240.50 m² çdo kat, vilië 4 katëshe, adresa e pasurisë Shkozë, Tiranë, në pronësi të Remzi Adil Muça. Çmimi me të cilin del kjo pasuri në ankandin e parë është 60.028.800 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e tetë mije e tetëqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Enforcement Group" sh.p.k. në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 1, Pallatet e Shoqërisë "Gora", Kati 3, Ap. 14, Tiranë në datën 30.11.2017, ora 16.00.
 Për kontakt: Cel: 0692087566; email: enforcementgroup2014@gmail.com



Dy deputetët përplasen për vendimin e qeverisë "Rama" për djegien e plehrave

Impiantet e mbetjeve, Vasili: Skandal Koka: Krenar, keqardhje për çdo miop

Ish-ministri: Duan ta shohin Shqipërinë varrezë landfilllesh

Djegia e mbetjeve ka përplasur dje, dy prej deputetëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ndërsa kryetari i Grupit Parlamentar, Petrit Vasili e ka cilësuar "skandal" atë të inceneratorëve të mbetjeve, ish-ministri i Mjedisit, Lefter Koka e quan këtë një vendim të drejtë të marrë nga qeveria "Rama". Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili në një shkrim në "Facebook", sulmon kryeministrin Rama për inceneratorët, duke thënë se vendimi i 2013-ës ishte i gabuar. Sipas Vasilit djegia e mbetjeve duhet të ishte e fundit, duke shtuar se ai vendim e fut në rrugën më të keqe trajtimin e mbetjeve dhe dëmton rëndë vendin për sot dhe dhjetëra vite në të ardhmen. "Strategjia e trajtimit të mbeturinave duke vënë në plan të parë djegien (incenerimin) është tërësisht e gabuar, sigurisht që kjo është bërë me qëllim. Kryeministri e ka kapur me qëllim për bishti problemim shumë të rëndë të mbetjeve. Ai po zbaton të parën atë që duhet të bënte të fundit. Kjo e fut në rrugën më të keqe trajtimin e mbetjeve, gjë që e dëmton rëndë vendin, për sot dhe për dhjetëra vjet në të ardhmen", - shkroi Vasili. "GIZ dhe qeveria gjermane e thonë qartë, po ku dëgjosh shokollëpaku? Shoqëria gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, e njohur ndryshe si GIZ, ka hedhur kritika të forta mbi qeverinë shqiptare për ndërtimin e inceneratorëve në disa rrethet të vendit. "Incenerimi, një proces që kthen mbetjet në energji është zgjidhja e fundit. Fatkeqësisht më duhet të them që investimet më të mëdha po shkojnë në pikat që kanë më pak prioritet", - është shprehur Hermann Plumm për "Dwelle", tha dje, Vasili. Ndërsa ish-ministri Lefter Koka tha dje, se mënyra e trajtimit të mbetjeve nëpërmjet djegies i ka dhënë fund pseudolandfillleve, që mes të tjerash kishin kosto të lartë. Koka



Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili



Ish-ministri Lefter Koka

KUVENDI
Me rastin e Festave të 28 dhe 29 Nëntorit, nga ora 10:00 deri në orën 14:00, Kuvendi i Shqipërisë organizon aktivitetin "Dyert e hapura" pranë sallës së seancave plenare. Përgjatë dy ditëve, dyert e sallës së seancës plenare do të jenë të hapura për qytetarët, të cilët mund të vizitojnë nga afër ambientet ku zhvillohen punimet e Kuvendit në seancë plenare.

Salianji: Rama, Tahiri dhe policia vepruan si organizatë kriminale

Deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Salianji aku zoi dje, kryeministrin Edi Rama se, së bashku me ish-ministrin Saimir Tahiri, janë një organizatë kriminale. Salianji tha dje, në një konferencë për mediat se i gjithë aktiviteti i Tahirit në Ministrinë e Brendshme ka qenë në funksion të menaxhimit dhe koordinimit të grupeve kriminale të trafikimit të drogës. Gjithashtu, Salianji shtoi se Saimir Tahiri u ka dhënë grupeve të trafikimit të drogës mbrojtje direkte fizike me policë në të gjitha hallkat e transportit të drogës nëpër territorin e Shqipërisë. "Hetimet e prokurorisë shqiptare, hetimet e prokurorisë së Katanias dhe fakte të reja që po zbulohen përditë nga partnerët ndërkombëtarë po zbulojnë të vërtetën tronditëse se qeverisja e Edi Ramës është një qeverisje e kriminalizuar në çdo nivel, në çdo hallkë dhe çdo veprim. Nuk kemi të bëjmë me raste të shkëlqyeshme, nuk kemi të bëjmë me individë të shkëlqyeshëm, por me një sistem të strukturuar kriminal, tha Salianji. "Mbi të gjitha, Edi Rama, Saimir Tahiri dhe të gjithë drejtuesit kryesorë të Policisë së Shtetit kanë vepruar si një strukturë kriminale në shërbim të veprimtarive të kriminit të organizuar, nga i cili kanë përfituar para dhe vota. Në mënyrë të veçantë, i gjithë aktiviteti i Saimir Tahirit në krye të Ministrisë së Brendshme ka qenë në funksion të menaxhimit dhe koordinimit të grupeve kriminale të trafikimit të drogës", tha deputeti i PD-së.

thekson se Impiantet e Prodhimit të Energjisë nga Mbetjet kanë jetëgjatësi mbi 50 vjet, kosto ndërtimi më e ulët se ajo e zbatuar në disa qarqe të vendit për landfill me zero tarifë depozitimi për bashkitë. Në fund të reagimit, Koka shprehet se është krenar për impiantet dhe i keqardhur, siç tha ai, për çdo miop që dëshiron ta shohë Shqipërinë varrezë masive landfilllesh. "Mbas shumë vitesh shpërdorim në formë grantesh dhe kredish që përfundonin në prodhim masiv letrash, pa asnjë produkt konkret, në vitin 2013, qeveria shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe në bashkëpunim me disa prej bashkive kryesore në vend morri një vendim të drejtë dhe të rëndë-

sishëm, për t'i dhënë fund njëherë e mirë problemit të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve", tha Koka. "Pas 7 vitesh këto vepra unike inxhinierike i kalojnë 100% në pronësi dhe administrim bashkive. Të ardhurat nga shitja e energjisë, bashkitë do të mund t'i përdorin për investim në pastrim dhe infrastrukturën e riciklimit. Krenar për këto impiante, i keqardhur për çdo miop që dëshiron ta shohë Shqipërinë varrezë masive landfilllesh", ka shkruar Koka në "Facebook".



PS Ilogari kreut të PD për kontratën lobuese

Klotilda Ferhati: Basha transferoi nga parajsat fiskale 1 mln USD

Partia Socialiste i kërkoi prokurorisë që të hetonte mbi kontratën lobuese të Partisë Demokratike, duke theksuar se shuma prej 1 mln dollarë është paguar nga parajsat fiskale. Deputetja Klotilda Bushka Ferhati i drejtoi disa pyetje kreut demokrat Basha, nëse shuma është përdorur për lajme të rreme në dëm të vendit. "Ajo që PD duhet të bëjë tani, është të japë përgjigje për pothuajse një milion dollarë, para të pista, që me firmën e vetë Lulzim Bashës, janë transferuar nga parajsat fiskale në vetëm tre muaj, nga marsi në qershor 2017. Sot Lulzim Basha, ka detyrën ligjore, meqë moralisht nuk do t'ia dijë, që të dalë përpara qytetarëve dhe të japë shpjegime për origjinën e këtyre parave", - u shpreh dje, deputetja e PS-së. "Lulzim Basha duhet të përgjigjet: Kush i pagoi këto para? Nga erdhën këto para? Cili është burimi i tyre?", - ngriti pyetjet Ferhati. "Basha duhet të shpjegojë, gjithashtu, se si Partia Demokratike mashtrroi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke fshehur plot një milion dollarë", - u shpreh ajo. "Ky është një skandal, që nuk mund të kalojë në heshtje, ashtu siç Basha është mësuar të bëjë, kur si ministër i fali 300 kilometra katrorë det Greqisë apo kur dha urdhrin për të vrarë katër qytetarë të pafajshëm në 21 janar. Ai, nuk mund të fshihet më, siç bëri me Rrugën e Kombit, kur iu shmang drejtësisë me një raport mjeku", - tha Ferhati.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Ne date 04.12.2017 në orën 16.00 në zyrën e permbauesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, në zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur në Lagja 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajguore Berat.Cmimi ne ankand te trette eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njebechete mije e dyqind) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Njofitim: Ne date 01.12.2017 në orën 16.00 në zyrën e permbauesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, në zonen kadastrale 1664, me adresë Lagja "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushë Kruej.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhete e nje mije e gjashtedqind e shtatedhete e nje pike tridhete e gjashte) lekë.

Njofitim për shitje me ankand
Sh. "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasurinë e debitorit V Gjikas, P Gjikas
Pasuria që shillet në ankand përbëhet nga :
"Apartament" me numër pasurie 31/202+1-6 faqe 160 Vol 44 , në ZK 8602 me siperfaqe 63.19 m² në Vlorë
Ankandi i pasurisë fillon me cmimin fillestar në masën 32.880 Euro
Ankandi do të zhvillohet datë 07.12.2017 orën 16:00, selin e shoqërisë "pall Gora" Bulv "Gj, Fishta" Kulla 3, Tiranë Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit liir.dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.



Pamje gjatë arrestimit

Policia: Pas kontrollit në disa banesa, i dyshuari u ndalua në lokal në "Unazën e re"

Në kërkim për tentativë vrasje, pranga 32-vjeçarit

Blendo Alikaj plagosi me armë zjarri tre vetë në janar 2017

Ina Allkanjari

VLORE

Uniformat blu kanë vënë dje në pranga 32-vjeçarin, Blendo (Edison) Alikaj, pasi ishte shpallur në kërkim për tentativë vrasje.

Specialistët e Seksionit për Krimet e Rënda në D.V.P.Vlorë bashkëpunuan



me Forcën e Posaqme Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së shtetit, për kapjen e ndalimin e 32-vjeçarit Alikaj. Pas një pune dhe hetimi intensiv, forcat policore kanë ushtruar kontrolle në ambiente të ndryshme dhe në tri banesa në Tiranë e Vlorë, ku dyshohej se mund të fshihej Blendo Alikaj.

Mbi bazën e informacioneve të siguruar nga qytetarët u lokalizua vendndodhja e tij në një lokal pranë vendit të quajtur "Unaza e re" në Astir, Tiranë. Si rezultat i ndërhyrjes së uniformave blu është kapur dhe ndaluar shtetasi Alikaj. Për 32-vjeçarin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka caktuar masën "Arrest me burg", pasi dyshohet se është autor i ngjarjes së ndodhur në qytetin e Vlorës më datë 04.01.2017, në lagjen "Hajro Çakëri", pranë poliklinikës, ku ka qëlluar me armë zjarri automatik dhe për pasojë kanë mbetur të plagosur tre shtetas. Gjatë kontrollit të

ushtruar në një nga banesat në Vlorë janë gjetur dhe sekuestruar 3 fishekë pistolette, 1 palë dorashka të zeza dhe 1 kapuç-maskë. Gjithashtu, në përfundim të veprimeve hetimore të kryera prej policisë ka rezultuar edhe si autor i dyshuar në ngjarjet e ndodhura më parë dhe konkretisht më datë 03.11.2016, në lagjen "Isa Boletini", të lulishtja e Kalit të Trojës, së bashku me një tjetër shtetas dyshohet të ketë qëlluar me armë zjarri automatik. Më datë 18.05.2017, në vendin e quajtur Jonufër së bashku me tre shtetas të tjerë dyshohet se ka shtrënguar me anë të kanosjes dhe dhunës një tjetër shtetas për dhënie e një shume të caktuar leutur masën "Arrest me burg", pasi dyshohet se është autor i ngjarjes së ndodhur në qytetin e Vlorës më datë 04.01.2017, në lagjen "Hajro Çakëri", pranë poliklinikës, ku ka qëlluar me armë zjarri automatik dhe për pasojë kanë mbetur të plagosur tre shtetas. Gjatë kontrollit të

NGJARJA

Për shtetasin Blendo Alikaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka caktuar masën "Arrest me burg", pasi dyshohet se është autor i ngjarjes së ndodhur në qytetin e Vlorës më datë 04.01.2017, në lagjen "Hajro Çakëri", pranë poliklinikës, ku ka qëlluar me armë zjarri automatik dhe për pasojë kanë mbetur të plagosur tre shtetas.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

- GENERAL CONDITIONS**
- 1.1 Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1
- 1.2 Profile:** The Conservation of Agrobiodiversity in Rural Albania – CABRA Project is implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (GIZ). The project aims to improve the conservation and sustainable use of natural and agricultural biodiversity in selected mountain areas of Albania. Das Vorhaben setzt auf nationaler Ebene (beteiligte Ministerien) und auf lokaler Ebene (in 3 Partnergemeinden) an. The project intervenes at national level (ministries involved) and at local level (3 partner municipalities Malësi e Madhe Tropojë and Shkodër). Im Handlungsfeld (1) werden Beiträge zur Neufassung der Nationalen Abfallwirtschaftsstrategie (Zwischenzeitraum 2015-2020) und der Sektorregulierung sowie zur Verbesserung der Kapazitäten und Koordinierung der beteiligten Akteure geleistet. At the local level the project contributes also to sustainable mountain development following the Sustainable Marketing and Destination Development concept for the Albanian Alps. At the local level the project supports three partner municipalities to promote the Albanian Alps as a tourism destination as well as the newly established Regional Nature Parks (RNPs) Shkrel and Nikaj - Mërtur.
- 1.3 Subject:** The objective of the present call is to develop three websites for the protected areas: a) Albanian Alps b) Nikaj Mërtur and c) Shkrel; respectively with domains albanianalps.al, shkrelpark.al and nikaj-merturpark.al, and train the staff of the municipality on website maintenance. In addition is required to develop the tourism logos of the Regional Nature Parks Shkrel and Nikaj -Mërtur and their brand book for logo application. We are seeking national web-design companies to (1) develop the three websites, (2) train the municipality staff on website maintenance, (3) develop manual on web-maintenance for the municipal staff, (4) design the logos of two RNPs Shkrel and Nikaj Mërtur (5) prepare the brand book on logo application for RNPs. The companies' should have strong track record in website development and have previous experience on developing websites for tourism promotion. The development of the websites will be done during the period of January until end of April 2018. The process requires frequent consultations with the tourism representatives of the three municipalities for the preliminary results. All the final products resulting from this assignment will have final consent by the tourism representatives assigned by the Municipalities of Shkodër, Malësi e Madhe and Tropojë.

The team of the company (one team leader, one web developer and one designer) is expected to coordinate and harmonize their work with the GIZ / CABRA project counterparts. The company's CEO/team leader is requested to make the coordination with CABRA management and its partners. The outcome and the process will be presented to key actors.

- 1.4 Eligibility:** Participation is open to all companies who are nationals of and effectively established in Albania.
- All legal entities interested in the application process should ask for [application forms](#) to the address: giz.albanien@giz.de

- The due date for submitting the application is **5thth December 2017**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Website and logo development for the Albanian Alps" to:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid.



SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLIEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament** me sip. 147 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8270, Numri Pasurise 3/40+1-16, Volum.42, Faqe.56. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **148.176 Euro**.
- 2- Garazh, Nr.1** me sip. 520 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G1, vol.18, faqe.72. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **445.536 Euro**.
- 3- Njesi** me sip. 50 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N2, vol.18, faqe.76. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **120.960 Euro**.
- 4- Garazh N.2** me sip. 50 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G2, vol.18, faqe.73. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **42.840 Euro**.
- 5- Garazh N.3** me sip. 570 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G3, vol.18, faqe.74. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **488.376 Euro**.
- 6- Apartament** me sip. 402.9 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise 3/241+1-1, Volum.18, Faqe.78. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **731.022 Euro**.
- 7- Njesi** me sip. 310 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N1, vol.18, faqe.75. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **750.920 Euro**.
- 8- Njesi** me sip. 364.7 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N3, vol.18, faqe.77. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **827.139 Euro**.

Ankandi per te gjitha pasuritë e sipërcituara **do te zhvillohet datë 05.12.2017 ora 16.00** në zyrat e shoqerise EPSA shpk te ndodhura ne adresen Rr. "I. Qemali", Pall. "Fratri", K.6,Tirane.

Zbardhet dinamika e ngjarjes, grabitësit vodhën 160.000 lekë

Dhunimi i dy të moshuarve në Shkallnur, në pranga 4 autorët

Policia: Ngjarja pas një sherri prone

DURRËS

Shtatë ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Shkallnur të Durrësit ku dy të moshuarit Maliq dhe Shahe Elezi u dhunuan dhe u grabitën nga persona të armatosur dhe me maska policia ka vënë në pranga autorët e dyshuar. Uniformat blu kanë vënë në pranga 4 persona 2 prej tyre vëllezër. Forcat policore zbardhën gjithë skemën e grabitjes. Dy ditë më parë policia njoftoi se shoqëroi dy persona të dyshuar ndërsa përmes tyre me sa duket ka arritur të zbardhë ngjarjen e plotë. Ndërkohë 77-vjeçari i dhunuar Elezi ndodhet ende në spital në gjendje të rëndë ndërsa bashkëshortja e tij ndonëse me hematoma të shumta dhe në gjendje të rëndur psikologjike ka arritur të lërë spitalin.

ARRESTIMET

Arrestimi i 4 autorëve u bë i mundur në bashkëpunim me policinë Kufitare Kakavijë dhe Drejtorinë e Policisë Korçë. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë Durrës në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës pas një pune hetimore intensive dhe të mirëorganizuar me metoda speciale pas provave të administruara në rrugë shkenore dhe procedurale kanë bërë të mundur



Arrestimi i autorëve nga policia

zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur më datë 20.11.2017. Gjatë grabitjes së banesës së një çifti bashkëshortësh në Shkallnur katër shtetas të maskuar i kanë dhunuar fizikisht të moshuarit. Autorët e dyshuar të cilën kanë rënë në pranga janë shtetasit: Niko Papajorgji 35 vjeç banues në Durrës; Marsel Papajorgji 30 vjeç banues në Durrës; Julian Qamili 43 vjeç banues në Durrës; Erind Seferkolli 30 vjeç banues në Korçë. Shtetasit e mësipërm

më datë 20.11.2017 rreth orës 03:00 në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë dhunuar fizikisht dhe kanë vjedhur banesën e shtetasve Maliq Elezi 77 vjeç dhe Shahe Elezi 69 vjeç banues në Shkallnur.

NGJARJA

Niko dhe Marsel Papajorgji (vëllezër me njëri-tjetrin) në rolin e nxitësve dhe ndihmësve kanë bërë roje ndërkohë që në banesë janë futur nga dritarja shtetasit Julian Qamili dhe Erind Seferkolli (ekzeku-

torët) të cilët kanë dhunuar dhe lidhur çiftin. Në vijim gjatë kontrollit të kryer në banesë kanë gjetur dhe kanë vjedhur 160 000 lekë të rinj. Më pas autorët janë larguar. Nga veprimet hetimore paraprake të kryera është bërë e mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorëve. Kapja dhe ndalimi i tyre është bërë e mundur si rezultat i bashkëpunimit të Policisë Kufitare Kakavijë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë. Të dëmtuarit shtetasi M.E. ndodhet në

GRABITJA NË SARANDË

Prokuroria e Sarandës ka nxjerr urdhër arresti për 34-vjeçarin me iniciale A. S. Ai dyshohet se natën e djeshme ka hyrë në banesën e 27-vjeçarit me iniciale L. K., duke vjedhur 20 milionë lekë të vjetër. Autori dyshohet se e ka kryer vjedhjen në bashkëpunim me disa persona të tjerë.



Spitalin Ushtarak Tiranë nën kujdesin e mjekëve ndërsa shtetësia S.H.E. është jashtë rrezeve për jetën. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprimet e mëtejshme për veprën penale "Vjedhja me dhunë" e kryer në bashkëpunim parashikuar në nenin 139 25 të Kodit Penal.



Durrës, u nis për të shkuar në punë, zhduket 18-vjeçari

DURRËS - Një 18-vjeçar është denoncuar nga familja i humbur, pasi prej tre ditësh nuk është kthyer në banesë. Stebastian Kovaçi 18 vjeç, banues në lagjen Nr.13 është larguar nga banesa më datë 24.11.2017 për të shkuar në punë dhe nuk është kthyer. Ai punonte në një parking në afërsi të Vullgës ndërsa nuk është paraqitur në punë më datë 24 nëntor. Policia po heton se çfarë ka ndodhur me 18-vjeçarin nga momenti që ka dalë nga banesa dhe rrugës për të shkuar në punë, pasi është zhdukur pa lënë gjurmë. Ai është rreth 1.50 cm i gjatë, me flokë ngjyrë të zezë, të preta shkurt dhe ka veshur një palë xhinse blu, një triko ngjyrë blu dhe atlete ngjyrë kafe.

Makina përplas për vdekje të moshuarën, dorëzohet shoferi

TIRANE -Pasditën e djeshme rreth orës 18:00 tek mbikalimi "Rinasit" ka ndodhur një aksident që i ka marrë jetën një të moshuare. 68-vjeçarja me inicialet R.L. po kalonte rrugën në momentin që u përplas me makinën nga Elton Doda 25 vjeç, banues në Mamurras. Drejtuesi i mjetit ka ndaluar dhe e ka transportuar vetë në spital 68-vjeçaren, e cila ka ndërruar jetë. Drejtuesi i automjetit ka njoftuar policinë dhe menjëherë, sipas bluve të Tiranës është kthyer në vendngjarje, ku janë kryer veprimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve të aksidentit. Sipas policisë, nga hetimet paraprake dyshohet se e moshuara ka tentuar të kalojë nga njëra anë e rrugës në tjetrën, ku si pasojë e lagështisë në rrugë dhe errësirës është goditur nga automjeti. Policia deklaroi se drejtuesi i mjetit do të shoqërohet në polici për veprime të mëtejshme.

Vendoset masa "Arrest shtëpie" për kryetarin e Pustecit

U akuzua për manipulim në zgjedhjet e Maqedonisë, lirohet Edmond Themelko

Kryetari i Bashkisë së Pustecit në Korçë, Edmond Themelko mund të lirohet nga burgu i Shutkës për të qëndruar në arrest shtëpie. Më 26 shtator 2017 ai u vetëdorëzua në komisarriatin e policisë pas lëshimit të urdhër-arrestit ndërkombëtar nga gjykata. Edmond Themelko është i akuzuar për rastin "Titanik" për parregullsi zgjedhore. Gjykata vendosi më 24 nëntor qëndrimin e tij sërish në burg, por këshilli mori masë më të butë



Edmond Themelko

duke e lënë në arrest shtëpie, raporton ALSAT. Përveç Themelkos, në "Titanik" akuzohen edhe ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski si dhe ministrit në qeverinë e tij, Gordana Jankuloska, Biljana Brishkovska-Boshkovska dhe Mile Janakieski. Sipas akuzës, banorëve të minoritetit maqedonas në Pustec, u janë dhënë letërnjoftime dhe direktivat nga Edmond Themelko se për cilën parti të votojnë në zgjedhjet e Maqedonisë.



Spitali i Burrelit

Çohet në spital i vdekur, roja 53-vjeçar, ka dëmtime

Burrel - Ibrahim Migla rreth 53 vjeç, banues në Komsi-Mat është dërguar pa jetë në spitalin e Burrelit. Ai ka pasur dëmtime në kokë e në trup. Nga veprimet paraprake të kryera nga grupi hetimor ka rezultuar se ai, punonte roje në një godinë të ish-parku i mallrave, dhe duke zbritur shkallët dyshohet se është rrezuar gjatë kapërcimit të murit rrethues duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Sipas njoftimit të policisë ngjarja dyshohet të jetë aksidentale, megjithatë hetimet do vazhdojnë.

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PERMBARIMIT
ZYRA PERMBARIMORE TIRANE

Zyra e Permbaritit Tiranë, me përmbareues gjyqësor Albert Fejzo, në baze të vendimit nr. 10019, datë 16.11.2017, shpall shpëtimin e ankandit të pasurisë apartamentit të banimit me sipërfaqe 57 m², të ndodhur në Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 në Zonën kadastrale 8260 të regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurisë Paluajtshme Tiranë në nr pasurisë nr.2/54+4/60, vëllume 6, faqe: 62 Tiranë, në vlerën 2.800.000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë.
Ankandi zhvillohet në ambientet e Zyres të Permbaritit Tiranë, në adresën: "Sheshi Mustafa Atilur, kryeqendri "21 dhjetori", Tiranë ditën e Premte, më datë 08.11.2017, ora 16.00.

Shoqëria përmbareore "AFA-2010" sh.p.k
shpall Ankandin për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3/269 e Illojt "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. truall 350 m² dhe sip. banesë 191,9 m². (kat përdehe 191,9 m², kat i 1.269.03 dhe katili 269 m²) ndodhur në L. "11 Janari", ZK. 2310, Kuçovë, në pronësi Agim Isa Zeqea.
Çmimi fillestar në ankandin e trete është 10.080.000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 18.12.2017, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbareore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.
Për info. Tel:044503458 ose
E-mail shogeria@permbareoreafa2010@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
PASURINË NR. 2/963-ND+1-43, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55, FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513, ME SIPERFAQJE 67,81 M², NË ADRESËN: RRUGA "K. KËRTUSHA", SHKALLA 1, KATI 7, DURRËS, NË PRONËSI TË SHTETASVE: Z. LUTFI GJYZELI DHE Z.NJ. ENKELIJE DA GJYZELI

ÇMIMI 4.000.000 LEKË", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 05.12.2017.

ZYRA PERMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE "ILIA ELEZË"
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Pallati "GORA", Kulla 1, Kati 2, Tiranë.
Cel:0684026666 ; 0693262866

Ministri i Mjedisit e të rinjtë mbjellin 300 pemë

Rikthimi i Tomorit në destinacion turistik, Klosi: Koha e shkatërrimit ka marrë fund



Blendi Klosi, me një grup të rinjsh në malin e Tomorit

Në shenjë simbolike për rikthimin e Parkut Natyror të Tomorit në një destinacion turistik dhe historik, ditën e djeshme është bërë mbjellja e 300 pemëve në këtë zonë. Vetëm një javë pas aksionit të ndërhyrjes dhe marrjes së masave për ndalimin e shkatërrimit të malit të Tomorit, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, së bashku me një grup të rinjsh, realizuan një ecje sportive drejt këtij mali. Kjo nismë vjen pasi ky vend përveç bukurive natyrore, ofron edhe

BLENDI KLOSI

"Një javë më parë erdhëm dhe dënuam krimin mjedisor që kanë bërë grupe barbarësh, por ne me të rinjtë duam të promovojmë turizmin natyror, bukuritë e natyrës që është më shumë se kaq një mrekulli botërore. Ftoj të gjithë ata që nuk e kanë parë, i ftoj të gjithë të vijnë ta vizitojnë, sepse të rinjtë do u bëjnë një guitë të mrekullueshme"

turizmin historik për të huaj e vendas. "Jemi me një grup të rinj nga qarku i Beratit, për të promovuar Parkun Natyror të Tomorit. Jemi në

kalanë e Tomorit, vend që sipas legjendave është një vend i mrekullueshëm, vend që sipas legjendave është një vend magjik." - tha ministri

Klosi. Më tej ai theksoi se koha e shkatërrimit dhe shfrytëzimit të malit të Tomorit ka marrë fund dhe se tani vendi do t'i kthehet zhvillimit të turizmit duke bërë ftesë për ta vizituar. "Një javë më parë erdhëm dhe dënuam krimin mjedisor që kanë bërë grup barbarësh, por ne me të rinjtë duam të promovojmë turizmin natyror, bukuritë e natyrës që është më shumë se kaq një mrekulli botërore. Ftoj të gjithë ata që nuk e kanë parë, i ftoj të gjithë të

vijnë ta vizitojnë sepse të rinjtë do u bëjnë një guitë të mrekullueshme", -tha Klosi në fjalën e tij. Ndërkaq, në kuadrin e zhvillimit turistik të vendit, edhe fshati Qafë-

Dardhë, pranë Malit të Tomorit, do të jetë pjesë e "100 fshatrave turistike", -nismë që ka marrë tashmë mbështetjen buxhetore të qeverisë.

Kreu i qarkut, Aldrin Dalipi: Kjo ditë, mësim për të gjitha brezat

Përkujtohet 105-vjetori i Pavarësisë së Tiranës

Veliaj: Të luftojmë për kryeqytetin

Voltiza Duro

Dje në kryeqytet u përkujtua 105-vjetori i Pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit. Tirana sollti në kujtesë edhe njëherë ditën kur patriotët Refik dhe Hamit Toptani, iu bashkuar arkitektit të pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemalit në projektin që do sillte lindjen e shtetit shqiptar. Pikërisht në sheshin ku para 105 vitesh, burra dhe gra patriotë tiranas ngritën Flamurin Kombëtar, ditën e djeshme para selisë së Kuvendit të Shqipërisë, personalitete të ndryshme, veteranët e luftës e qytetarët kremtuan këtë ditë. Kryebashkiaku Erion Veliaj, nënkryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi, prefekta, Suzana Jahollari, kreu i Këshillit të qarkut, Aldrin Dalipi, përfaqësues të komuniteteve fetare, veteranë lufte dhe qytetarë të Tiranës, vendosën kurora me lule në monumentin që simbolizon këtë moment historik për qytetin e Tiranës. Veliaj uroi të gjithë qytetarët për festën e pavarësisë së kryeqytetit ku theksoi se ky akt i atdhetarëve tiranas 105 vite më parë tregoi se Tirana ka qenë gjithmonë një qytet pararojë. "Në këtë ditë të bukur, gëzuar Festën e Pavarësisë së Tiranës! Tirana gjithmonë ka qenë avangard. Me sa duket kjo qen-



Aktiviteti me rastin e 105-vjetorit të Pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Tiranë

ka shkruar në histori. Tirana ka shpallur pavarësinë dy ditë përpara Pavarësisë së Shqipërisë edhe për faktin që ishin zonat ende të pa pushtuara dhe të parrethura nga armiqet, zona e Elbasanit, zona e Tiranës, ndërkohë që armiqet po i afroreshin Krujës e pastaj Durrësit e më pas Vlora", -tha kryebashkiaku. Më tej, ai u shpreh se ditë të tilla duhet të shërbejnë për të kuptuar se, ashtu si patriotët të qytetit të Tiranës 105 vite më parë morën përsipër të shpallnin pavarësinë e Tiranës, ashtu edhe sot qytetarë të saj duhet të shërbejnë për ta çuar Tiranën akoma më përpara në betejat e tjera me të cilat përballlet sot njerëzimi, siç është varfëria. "Unë besoj që sot thirrja është të vazhdojë të

jetë në avangardë, edhe për pavarësi të tjera, për pavarësinë nga varfëria, nga injoranca dhe besoj që Tirana do të vijojë të jetë kryeqytet jo vetëm i Shqipërisë, por edhe i gjithë shqiptarëve. Sapo u

kthjem nga Brukseli ku kanë filluar përgatitjet për festën e Pavarësisë dhe më vjen mirë që kausa shqiptare sot është me fortë se kurrë dhe të gjitha burojnë nga energjia e Tiranës. Nëse

KRYEBASHKIAKU

"Tirana do të vijojë të jetë kryeqytet jo vetëm i Shqipërisë, por edhe i gjithë shqiptarëve. Sapo u kthjem nga Brukseli ku kanë filluar përgatitjet për Festën e Pavarësisë dhe më vjen mirë që kausa shqiptare sot është me fortë se kurrë dhe të gjitha burojnë nga energjia e Tiranës", -tha Veliaj.

Prezantimi në Panairin e Agrobiznesit

Aktivitetet që do zhvillohen për 28-29 Nëntorin

Kryebashkiaku Erion Veliaj, në përkujtimin e 105-vjetorit të Pavarësisë së kryeqytetit, bëri publike disa prej aktiviteteve që do të mbahen në Tiranë më rastin e festave të 28-29 Nëntorit. "Do të vijomë me festimet në 28 Nëntor, me ngritjen e Flamurit, në orën 10.00 paradite, ku ftoj të gjithë qytetarët të bëhen pjesë. Për herë të parë ngremë Flamurin në sheshin e ri "Skënderbej", pastaj gjatë gjithë ditës, do të kemi një sërë aktivitete. Nata e Bardhë do të rikthehet fuqishëm në Tiranë. Kemi koncerte, aktivitete të ndryshme, ndaj ftoj të gjithë qytetarët të bëhen pjesë e kësaj energjie të Tiranës, për të kujtuar të parët tanë dhe për të kujtuar premtimin që i kemi bërë kësaj toke, që sa të kemi mundësi, pavarësisht pozicionit, secili të bëjë të pamundurën për t'i shërbyer vendit", -tha Veliaj. Gjithashtu, në axhendën e aktiviteteve për Natën e Bardhë në 29 Nëntor është edhe performanca e këngëtarës britanike, Emeli Sande në sheshin "Skënderbej". "Kësaj here në skenë do të ngjitet e mrekullueshëmja Emeli Sande, të cilën Bashkia e Tiranës e ka ftuar të jetë pjesë e festës që do të kulmojë pikërisht me një koncert madhështor për të gjithë të pagjumët e kryeqytetit. Tradita vijon, Tirana do të jetë më e ndriçuar se kurrë në 29 Nëntor, kur dyert e artit dhe kulturës do të hapen për të gjithë qytetarët dhe kryeqyteti do t'i jepet festës deri në agim" -thuhet në njoftimin e bashkisë së Tiranës. Ndërkaq, në 29-30 Nëntor do të mbahet dhe Panairi i Agrobiznesit në sheshin "Nënë Tereza" dhe bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ku do të prezantohen ushqimet shqiptare.

kemi një kryeqytet që vazhdon me punë, një kryeqytet që vazhdon me entuziazëm, që vazhdon me optimizëm, kjo reflektohet kudo", -shtoi Veliaj. Kreu i qarkut Tiranë, Aldrin Dalipi theksoi se kjo datë do të duhet të jetë një mësim për gjithë brezat që


ne t'i kujtojmë ata dhe t'i vlerësojmë. Ndërsa prefekta e Tiranës, Suzana Jahollari, vlerësoi sakrificat dhe vizionin e atyre të cilët kanë kontribuar për pavarësinë e Tiranës, ndërsa nënvizoi se Tirana mbetet pikë referimi për gjithë kombin.

Gjergj Buxhuku: Studime sipas standardeve të BE-së

Konfindustria: Stop ndërtimet në Vjosë

Konfindustria i ka kërkuar zyrtarisht Kryeministrit të Shqipërisë dhe vendimmarrjes politike, ndërprerjen e procedurave ligjore për ndërtimin e veprave energjetike në lumin Vjosa, përfshi edhe HEC e Kalivaçit. Sipas Konfindustriës është e papranueshme, që veprat energjetike në lumin Vjosa të kryhen me studime ekonomike të vjetra 10-20 vjeçare, në një kohë që mundësitë e modeleve të reja për

zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, kanë ndryshuar në mënyrë rëndësore. "Është e nevojshme të kryhen studime kosto-përfitim të plota mjedisore sipas standardeve të BE, që sot mungojnë krejtësisht në legjislacionin shqiptar të dhënies së koncesioneve. Në rastin e HEC të Kalivaçit moratoriumi është i domosdoshëm", -thotë në njoftimin për shtyp administratori i përgjithshëm, Gjergj Buxhuku.



Lumi Vjosa

Intervistë me diplomatën Makoto Ito. Ngjashmëritë tona...

Ambasadori japonez: Projektet që jemi duke realizuar në Shqipëri

"Mbështesim përpjekjet e vendeve ballkanike për anëtarësim në BE"

Nga Genc Mlloja

Në prill të vitit 2017, Japonia ka në Tiranë diplomatët e saj, e hapja e Ambasadës i ka dhënë një impuls të re marrëdhënieve mes dy vendeve. Ambasadori japonez Makoto Ito, në këtë intervistë tregon se si e sheh Shqipërinë, ku janë fazat e projekteve të shtetit të tij në vendin tonë dhe detajet të tjera për marrëdhënien mes dy vendeve.

- Z. Ambasador, rritja e nivelit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Japonisë, e cila kulmoi me hapjen e ambasadës në prill të këtij viti dhe paraqitjen e letrave kredenciale nga ju më 6 qershor, kanë shënuar një etapë të re në marrëdhëniet dypalëshe midis dy vendeve tona. Si do t'i vlerësonit nivelin e tanishëm dhe perspektivën e marrëdhënieve shqiptaro-japoneze?

Shqipëria dhe Japonia janë partnerë të rëndësishëm, të cilët ndajnë vlera të përbashkëta themelore si demokracia, ekonomia e tregut të lirë, të drejtat e njeriut.

Për më tepër Japonia dhe Shqipëria kanë shumë ngjashmëri, njerëzit janë punëtorë të mirë, respektojnë vlerat e familjes, dhe të dy vendet janë të mirënjohur për karakterin e tyre miqësor, mikpritjen, natyrën e mrekullueshme, malet, bregdetin dhe lumenjtë.

Kësisoj është e natyrisht që vende të tilla të njëjta të vendosin lidhje miqësore dhe të ngushta.

- Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Japonisë kanë një histori të vjetër dhe ata karakterizohen edhe nga predispozicioni i vendit tuaj për të ndihmuar Shqipërinë, veçanërisht pas vendosjes së pluralizmit në fillim të viteve 90. Cilat janë disa nga momentet kryesore të ndihmës në rritje japoneze?

Deri tani nëpërmjet Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) ose agjencive të tjera qeveritare, Japonia ka mbështetur zhvillimin e Shqipërisë. Projektet që janë duke u realizuar tashmë nëpërmjet ndihmës së Japonisë janë:

1. "Projekti i përmirësimit të sistemit të ujërave të zeza i Tiranës së madhe" është një projekt, i cili ka si qëllim përmirësimin e cilësisë si të ujërave nëntokësore ashtu edhe të ujit të lumit duke ndërtuar impiantë në zonën e Tiranës së Madhe.

2. "Projekti mbi informacionin gjeohapësor" dhe zhvillimin e qëndrueshëm



Ambasadori japonez në Shqipëri, Makoto Ito

në rajonin Tiranë-Durrës, që ka filluar në janar 2017. Ai ka si objektiv forcimin e veprimtarisë së zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike të kësaj zone duke përdorur harta topografike dixhitale të shkallës së lartë.

3. Ndihma në formë granti për projekte lokale në Shqipëri arrin një shumë vjetore prej afërsisht 75.000 dollarë çdo vit.

Dhe shpresojmë që projekte të tjera do të bëhen të mundur në të ardhmen.

- Ndërkohë janë ndërmarrë hapa për të forcuar dhe diversifikuar bashkëpunimin ekonomik midis Japonisë dhe Shqipërisë, dhe kjo e fundit është e etur për të thithur biznese nga vendi juaj për investime. Cilat janë disa nga potencialet që, sipas jush, mund të shfrytëzohen dhe cilat janë fushat më tërheqëse?

Krahas ndihmës ekonomike, tani kompani japoneze kanë filluar të jenë më të interesuara për të investuar në Shqipëri në

të ardhmen. Unë shpresoj që marrëdhëniet e biznesit do të forcohen dhe, si ambasador i Japonisë, u shpejtoj dhe njoftoj organet ekzekutive të bizneseve japoneze mbi ambientin pozitiv të tanishëm të biznesit në Shqipëri.

Avantazhet e Shqipërisë përfshijnë forcë punëtore tepër të kualifikuar, që është e përafërt me tregjet europiane. Nga ana tjetër, fushat më tërheqëse janë ata të manufakturës, turizmit dhe të tjera.

- Shteti ligjor, demokracia, dhe mirëqenia e popullit, ndër të tjera, përcaktojnë suksesin e një qeverie, por mbi të gjitha kjo është detyra e saj. Duke ndjekur funksionimin e sistemit demokratik në Japoni, vërej se shpesh ju zhvillojnë zgjedhje edhe të parakohshme. Në tetor të këtij viti kryeministri Shinzo Abe fitoi një mandat tjetër. Z. Ambasador, si mund të jepni përvojën tuaj në këtë fushë në Shqipëri?

Në zgjedhjet e fundit të

përgjithshme, qeveria e kryeministrit Abe siguroi një mbështetje më të madhe të popullsisë. Unë mendoj se qeveria Abe duhet të vazhdojë të zhvillojë më tepër politika të brendshme dhe diplomatike.

Qeveria japoneze mbështet fort përpjekjet shqiptare për reformim, duke përfshirë reformën në sistemin e drejtësisë.

- Duke folur për politikën e jashtme të qeverisë së re, cilat janë disa nga objektivat kryesore në rajon, por edhe në shkallë botërore?

Aktualisht, diplomacia e jashtme e qeverisë japoneze ka tri shtylla kryesore. Një shtyllë kryesore për qeverinë e Japonisë është të ruajë aleancën e fortë politike, ekonomike dhe të mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara.

Qeveria jonë, gjithashtu, i kushton përparësi ruajtjes dhe forcimit të marrëdhënieve miqësore dhe paqësore me vendet fqinje si dhe me Bashkimin Europian dhe vende të tjera europiane.

Një përparësi tjetër është të forcojë bashkëpunimin shumëpalësh dhe të kontribuojë në fushën e çarmatimit, sigurimit njerëzor, dhe bashkëpunimi ekonomik është, gjithashtu, një shtyllë e diplomacisë së jashtme të Japonisë.

- Shkëlqesia Juaj, karriera e juaj diplomatike është në një mënyrë e lidhur me Ballkanin edhe më parë para se të caktoheshit si ambasador në Tiranë. Duke pasur parasysh përvojën tuaj si i vlerësoni zhvillimet më të fundit në rajon, veçanërisht sa i përket aspiratës së vendeve të rajonit për t'u anëtarësuar në BE?

Shumë e natyrshme është që vendet e Ballkanit të kenë si aspiratë të tyre anëtarësimin në Bashkimin Europian, t'i bashkohen një organizate rajonale më të madhe, e cila ndan vlera dhe burime të përbashkëta në fushat e politikës, ekonomisë dhe mbrojtjes.

Si qeveri japoneze na i mbështesim këto aspirata

dhe përpjekje.

- Megjithëse nuk ka shumë kohë që ju jeni në Shqipëri, por duke ndjekur veprimtarinë tuaj është e dukshme që keni vizituar një pjesë të madhe të vendit. Cilat janë përshpjetat tuaj duke i parë gjërat jashtë kryeqytetit, duke takuar njerëz të zakonshëm në pjesë të ndryshme të Shqipërisë?

Gjatë kësaj vere, në mënyrë intensive unë kam bërë vizita në qytete të ndryshme si Kukës, Shkodër, Tropojë, Durrës, Berat, Gjirokastrë, Korçë. Kam pasur mundësinë të takoj kryetarë bashkish, përfaqësues të ekonomisë dhe kulturës.

Gjatë këtyre takimeve, kam pasur rastin të diskutoj mbi marrëdhëniet dypalëshe. Ndërkohë ata kanë shprehur interesin e madh për të forcuar bashkëpunimin me Japoninë, veçanërisht në fushën e shkëmbimeve kulturore dhe investimit të kompanive japoneze dhe bashkëpunimin ekonomik.

“

Qeveria jonë u kushton përparësi ruajtjes dhe forcimit të marrëdhënieve miqësore dhe paqësore me vendet fqinje si dhe me Bashkimin Europian, si dhe të forcojë bashkëpunimin shumëpalësh dhe të kontribuojë në fushën e çarmatimit e sigurimit njerëzor. Bashkëpunimi ekonomik është, gjithashtu, një shtyllë e diplomacisë së jashtme të Japonisë.

Avokati i shoqatave të ushtarakëve replikë me ish-kryetarin e Kushtetueses, Fehmi Abdiu

Bashkim Asllani *

Bashkim Asllani: Gjykatat, qëndrim diskriminues ndaj ish-ushtarakëve

“Padia plotësonte kushtet legjitime”

Lexova me vëmendje një shkrim të ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë sa i përket qëndrimit që kishte mbajtur Gjykata Kushtetuese për kërkesën që kishin paraqitur shoqatat e ushtarakëve në lidhje me Vendimin Unifikues Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.3/2016.

Nga artikulli i botuar konstatova se intervista e dhënë nga ish-kryetari Abdiu ishte vetëm një intervistë për protagonistin dhe nuk përmbante asnjë mendim, sugjerim apo analizë të mirëfilltë ligjore dhe kushtetuese, bile as referim tek Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të bindur lexuesit, se vërtet kërkesa e Shoqatave të Ushtarakëve nuk mund të shqyrtohej dhe aq më pak të pranohet nga ajo Gjykatë.

Përveç sa sipër në intervistë rezultojnë edhe disa pasaktësi juridike dhe faktike. Së pari, Z. Fehmi Abdiu, edhe për shkak të pozicionit që ka mbajtur, e di shumë mirë që, klasa politike dhe sistemet gjyqësore në Shqipëri kanë mbajtur një qëndrim të hapur diskriminues, përcmues dhe denigrues ndaj ushtarakëve dhe ish-ushtarakëve.

Së dyti, nëse do të ishte e vërtet sa thotë ish-kryetari, se kërkesa nuk mundëj të merrej në shqyrtim, pasi shoqatat e ushtarakëve nuk legjitimohen të kërkojnë shfuqizimin e një Vendimi Unifikues, atëherë për çfarë arsye Gjykatës Kushtetuese iu deshën 6 muaj për të kuptuar se ishin përpara një subjekti që nuk legjitimohet. Kërkesa e shoqatave është dorëzuar në Gjykatë Kushtetuese në mesin e muajit maj 2017, ndërsa vendimi është marrë në mesin e muajit nëntor 2017. Mungesa e legjitimitetit përbën shkak që çështja të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare, ndërkohë që në rastin konkret kërkesa e ka kaluar këtë fazë dhe është shqyrtuar në seancë plenare.

Së treti, çka është dhe më e rëndësishmja dhe që lidhet me pjesën juridike dhe kushtetuese të problemit. Në intervistë deklarohet se qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese është i saktë, pasi shoqatat nuk legjitimohen për t'iu drejtuar gjykatës dhe të kërkojnë shfuqizimin e një Vendimi Unifikues. Pra, ju thonë që shoqatat/organizatat, për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të anëtarëve të tyre, kanë të drejtë të kërkojnë vlerësimin kushtetues të një ligji, të një Vendimi të Këshillit të Ministrave dhe nuk kanë të drejtë ligjore të kërkojnë vlerësimin kushtetues të një Vendimi Gjyqësor?

Vendimi Unifikues i

REFUZIMI

Çështja kushtetuese e ngritur kishte lidhje të drejtpërdrejtë me interesat jetësore, ekonomike dhe sociale të shoqatave kërkuese dhe anëtarëve të tyre. Prandaj, edhe refuzimi i saj për të trajtuar çështjen e ka thelluar antikushtetutshmërinë, madje duke shkelur edhe vetë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, një rast ky i paprecedent.

Gjykatës së Lartë si një akt që unifikon praktikën gjyqësore sa i përket zbatimit të ligjit, mund t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit kushtetues, si çdo vendim dhe akt tjetër, për të cilin pretendohet se cenon të drejtat kushtetuese të subjekteve të caktuara, në rastin konkret të të gjithë anëtarëve të shoqatave kërkuese.

Për më tepër që, nëse do të kishte lexuar vendimin në fjalë, pra atë me nr.3/2016, si një profesionist i vjetër do të ishte i lahtaritur. Me atë vendim Gjykata e Lartë i ka dhënë të drejtë vetes të bëjë edhe gjykatën, edhe legjislativin edhe ekzekutivin, duke ndryshuar ligje, duke i ridhënë fuqi juridike ligjeve, të cilat ishin shfuqizuar nga parlamenti, si dhe duke përcaktuar ajo vetë mënyrat dhe rregullat se si do të zbatoheshin ligjet. Praktike kjo, e cila vetëm në përputhje me Kushtetutën nuk është, pasi ç'kuptim do të kishte atëherë parimi kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, aq shumë i trumbetuar.

Nga ana tjetër, mënyra se si ka vendosur Gjykata e Lartë të "rregullojë" zbatimin e ligjit, cenon hapur; rëndë dhe në mënyrë tërësisht arbitrare të drejtat ligjore dhe kushtetuese të shoqatave kërkuese dhe të të gjithë anëtarëve të tyre pa përjashtim. Kusht i vetëm ky për të legjitimuar kërkesat për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Por, argumenti, ose më saktë justifikimi, i përdorur nga Gjykata Kushtetuese, dhe i vlerësuar si i rregullit dhe i ligjshëm nga ana Juaj, nuk qëndron edhe për një shkak tjetër: Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se, Vendimi Unifikues nuk hyn në



Avokati i shoqatave të ushtarakëve, Bashkim Asllani

kategorinë e akteve që parashikohen nga neni 116 i Kushtetutës. Ish-Kryetar, sikurse sqarova edhe pak më lart, është nonsens juridik të thuash që një subjekt ka të drejtë të paraqes kërkesë për një ligj, vendim të Këshillit të Ministrave apo vendim të Gjykatës së Lartë, dhe i njëjti subjekt nuk ka të drejtë aksesit për një vendim unifikues. Neni 116 i Kushtetutës nuk duhet vlerësuar dhe analizuar i ndarë nga neni 131, 134/h i Kushtetutës dhe neni 49 i ligjit Nr.8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë."

Konkretisht këto dispozita përcaktojnë se organizatat/shoqatat hyjnë në kategorinë e subjekteve, të cilat kanë të drejtë/legjitimohen

për të paraqitur kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese. Neni 49/3/d i ligjit funksional të Gjykatës Kushtetuese sanksionon qartë se, "Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe: ...d) organet e bashkësisë fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendohet se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre...". Akti në fjalë, Vendimi Unifikues nr.3/2016, jo vetëm që cenon rëndë liritë dhe të drejtat e anëtarëve të shoqatave, por është një akt i marrë në shkelje shumë të rënda procedurale dhe një akt përmasë të cilit Gjykata e Lartë i jep të drejtë vetes të rivlerë në fuqi ligje të shfu-

qizuara më parë nga pushteti legjislativ.

Në lidhje me këtë moment, praktika e vetë Gjykatës Kushtetuese është tejte e konsoliduar dhe e qartë, për fat të mirë. Për ta konkretizuar sa sipër po i referohem vetëm disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, në të cilat ajo ka përcaktuar qartë kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që një shoqatë/organizatë të legjitimohet për t'iu drejtuar gjykatës.

Gjykata Kushtetuese, në Vendimin nr. 35, datë 10.10.2007, Vendimin nr. 9, datë 19.03.2008, Vendimin nr. 33, datë 24.06.2010, Vendimin nr. 31, datë 18.06.2010, Vendimin nr. 24, datë 24.07.2009, Vendimin nr. 11, datë 06.04.2010 dhe Vendimin nr. 7, datë 12.03.2010, ka arsyetuar se, "Shoqatat ose organi-

zatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtetuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak." Tek të gjitha këto vendime që citova më lart, të cilat kanë vendosur kufijtë ligjorë dhe kushtetues që duhet të plotësojë një shoqatë, për t'u legjitimuar përpara Gjykatës Kushtetuese, i nderuar Z. Fehmi keni qenë anëtar i gjykatës, duke dhënë dhe kontributin tuaj personal në këtë drejtim.

Nëse analizohet rasti konkret në dritën e këtyre kushteve apo kritereve legjitimuese, rezulton se kërkesa i plotësohet të gjitha kushtet e vendosura nga vetë gjykata për t'iu drejtuar asaj. Çështja kushtetuese e ngritur kishte lidhje të drejtpërdrejtë me interesat jetësore, ekonomike dhe sociale të shoqatave kërkuese dhe anëtarëve të tyre. Prandaj, edhe refuzimi i saj për të trajtuar çështjen e ka thelluar antikushtetutshmërinë, madje duke shkelur edhe vetë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, një rast ky i paprecedent.

Prandaj i nderuar, arsyetimi Juaj nuk qëndron në asnjë pikë të tij, dhe Shoqatat e Ushtarakëve kanë qenë në të drejtën e tyre ligjore dhe Kushtetuese. Refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të trajtuar themelin e çështjes lidhet pikërisht me faktin që, Gjykata ka qenë e ndërjegjeshme për pajtueshmërinë me Kushtetutën të Vendimi Unifikues nr.3/2016, por edhe pse formalisht ajo është garante e Kushtetutës, për të mos dalë kundër një rryme të fortë anti-ushtarakë që po vejeton për gati tri dhjetë vjet me radhë, ajo zgjodhi rrugën e antikushtetutshmërisë.

Avokati i shoqatave të ushtarakëve, Bashkim ASLLANI



3 FORMAT KRYESORE TË KËSAJ DROGE



Cilat janë efektet negative të kanabisit në organizëm

PËR NJË ZEMËR TË SHËNDETSHME



10 mënyra për të parandaluar sëmundjet kardiovaskulare

Vjola Fera:

◆ Mjekja e familjes: Llojet e analizave që përfshihen, ja sa besojnë pacientët



Mos e neglizhoni check up-in, parandalon në kohë sëmundjet

"Cilat janë kategoritë që e përfitojnë falas"

• Konsumoni arra për të ulur presionin e gjakut e për të luftuar sëmundjet nervore

Mjekja e familjes: Llojet e analizave që përfshihen në këtë shërbim, ja sa besojnë pacientët

Vjola Fera:

Mos e neglizhoni check up-in, parandalon në kohë sëmundjet

"Cilat janë kategoritë që e përfitojnë falas"



Mjekja e familjes, Vjola Fera

Voltiza Duro

Check-up është një pakete ekzaminuese e ofruar falas në vendin tonë për grup moshat 35-70 vjeç, e cila ndihmon në kontrollin, identifikimin dhe diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve. Por në Shqipëri, ende shumë pacientë nuk kanë besim mjaftueshëm te ky shërbim, e për pasojë ka raste kur pasi bëjnë kontrollin në shtet, i drejtohen edhe njëherë dyerve të privatit për siguri. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja e familjes, Vjola Fera tregon rëndësinë e kryerjes së këtij shërbimi mjekësor dhe përfitimet që vijnë prej tij duke theksuar se shëndeti është parësor dhe nuk duhet neglizhuar kurrë. Më tej ajo shpjegon të gjitha llojet e analizave dhe ekzaminimeve që përfshihen në check-up, dhe tregon për të gjitha kategoritë që e përfitojnë falas.

Cfarë është shërbimi i check-up?

Check-up është një paketë kontrolli mjekësor bazë për çdo person në grup moshën 35-70 vjeç në Republikën e Shqipërisë. Është një program i ofruar falas nga bërthama e sistemit shëndetësor të kujdesit parësor, siç është mjeku i familjes. Qytetarët janë të ftuar të kryejnë këtë paketë shërbimi me qëllimin e vetëm për kujdesin ndaj shëndetit, sepse kushton shumë më pak apo sëmundja mposhtet më lehtë nëse bëhet depistimi i hershëm dhe parandalimi në kohë, sigurisht dhe trajtimi dhe prognoza kanë rezultate pozitive në luftën me sëmundjet e sidomos ato jetëkërcënuese.

Cilat kategori e përfitojnë falas këtë shërbim?

Paketa e kontrollit mjekësor bazë është falas për grup moshën 35-70 vjeç pa dallim nëse je apo nuk je i siguruar, me ose pa kartë shëndeti, është gjithëpërfshirëse.

Cilat analiza përfshihen në check-up?

Në këtë paketë shëndetësore, analizat që kryhen përfshijnë elektrokardiogramën, e cila ka dhënë rezultate shumë të kënaqshme për prevalencën e sëmundjeve akute të zemrës apo gjëjen e rasteve me hipertension të stadi 1. Gjithashtu, check up përfshin edhe analizën e gjakut komplet, ku nga puna ime si mjekje familje kam debistuar dhe kemi kapur raste dhe me Hb 7mg/dl që sigurisht i kemi fil-

kapur në kohe stadin e Tumorit në traktin intestinal.

Pse duhet kryer check-up dhe cilat janë përfitimet prej tij?

Ky program nuk është detyrues, por duhet të bëhet e qartë se kontrolli i shëndetit është

ullatë si rezultat i stilit të jetesës ku mund të përmendim diabetin e hipertensionin. Por diagnostikimi i hershëm sjell në një trajtim më të shpejtë e efikas, veçanërisht të tumoreve.

Brenda sa kohësh dalin përgjigjet e analizave?

Check-up është një paketë kontrolli mjekësor bazë për çdo person në grup moshën 35-70 vjeç në Republikën e Shqipërisë. Është një program i ofruar falas nga bërthama e sistemit shëndetësor të kujdesit parësor, siç është mjeku i familjes. Qytetarët janë të ftuar të kryejnë këtë paketë shërbimi me qëllimin e vetëm për kujdesin ndaj shëndetit



luar direkt pacientit mjekimin për aneminë dhe sot është shumë mirë nga ana shëndetësore pasi u diagnostikua në kohë. Më tej kjo paketë shëndetësore falas përfshin analizat biokimike, glicemia, bilanci lipidik, analiza urinës komplet dhe fecë për gjak okult, dhe nga kjo analizë kam patur dy raste në praktikën time si mjekje që pasi kemi parë që ka dalë pozitive pacientët i janë nënshtruar egzaminimeve të tjera dhe e kemi

të rëndësishëm për cilindo prej nesh. Ne punojmë gjithë jetën për të fituar dhe në fund duhet të harxhojmë kursimet për t'u mjekuar ndërkohë që një jetë me kualitet përfshin kujdesin e vazhdueshëm ndaj vetes për të qenë mirë me shëndet, mirëqenie fizike dhe mendore. Check-up-i ka një rëndësi të madhe në parandalimin, diagnostikimin e hershëm, sidomos të sëmundjeve akute apo atyre me incidencë të lartë në pop-

jet e analizave?

Marrja e analizave kryhet në kabinetet e kontrollit bazë, të ngjitur pranë qendrave shëndetësore në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe në pikat më të largëta, ky shërbim ofrohet falas me makina lëvizëse. Përgjigja e analizave jepet për një deri në dy javë. Programi mjekësor bazë ofrohet nga kujdesi parësor shëndetësor. Pjesë e rëndësishme në këtë proces është edhe mjeku i familjes dhe stafi infermi-

ror që kryen procedurën e marrjes së analizave.

Sa besim kanë pacientët mbli kryerjen e check-up-it?

Në punën time të përditshme si mjekje ka pacientë që vijnë dhe vetë të kryejnë kontrollin, të kënaqur për shërbimin e ofruar dhe besimin tek analizat. Por ka dhe nga ata pacientë që bëjnë kontrollin dhe shkojnë i bëjnë dhe te një laborator tjetër dhe shohin që marrin të njëjtën përgjigje. Pacientët e vlerësojnë faktin që kjo paketë mbi të gjitha është falas, sepse po të shkojnë te privati duhet të paguajnë 8000 lekë. Përveç besimit mendoj se është thyer miti "kur të jem sëmurë, shkoj te mjeku", pasi njerëzit janë më të ndërgjegjësuar për kujdesin ndaj shëndetit.

Sa interes kanë treguar shqiptarët për këtë shërbim?

Unë personalisht si mjekje mendoj se shqiptarët e kanë pranuar dhe i përgjigjen ftesës për të kontrolluar shëndetin e tyre. Përgjithësisht të sëmurët kronikë janë gjithmonë të shqetësuar se si janë me shëndet ndonëse janë nën mjekim për sëmundjen, duan të jenë nën kontroll me analizat. Vlen të theksojmë faktin se kjo është një paketë që shtrihet në të gjithë Shqipërinë, pra në çdo skaj. Check-up përfshin një paketë analizash, të cilat i bën pa pasur nevojën për të zbatuar sistemin e referimit.

Cila është thirrja juaj për ndërgjegjësimin e opinionit publik mbli kryerjen e check-up-it?

Ndërgjegjësimi i opinionit publik duhet të fillojë në ndryshimin e konceptit për shëndetin. Njerëzit duhet ta kuptojnë se është më e rëndësishme të kujdesesh, të jesh nën kontroll të vazhdueshëm për një jetë sa më të shëndetshme, një stil kualitativ. Gjithashtu, duhet të ndërgjegjësohen se duhet të rrinë pranë mjekut të familjes, e të kenë kujdes në parandalimin e diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme.



Kanabis është një drogë që vjen nga bimët e kërpit Indian, si Cannabis sativa dhe Cannabis indica. Kimikati kryesor aktiv në kanabis është THC (delta-9 tetrahydrocannabinol). Kanabis është një drogë depresive. Drogat depresive nuk të bëjnë të ndihesh medoemos në depresion. Ato ulin aktivitetin e sistemit nervor qendror dhe të mesazheve që shkojnë midis trurit dhe trupit. Kur merren doza të larta kanabis mund të shkaktohen edhe efekte halucinogjen-e. Kanabis njihet edhe si bar apo hashash e gjetet nga bima e tij janë në ngjyrë të gjelbër të hapur dhe kanë një formë të dallueshme me pesë ose shtatë fletë. Kjo bimë përdoret për efektet psikoaktive (ndryshim i sjelljes dhe të menduarit), efektet të THC dhe përbërësve të tjerë aktivë. THC është kimikati në kanabis që bën që të ndihesh "mirë".

Tre forma kryesore të kanabisit psikoaktive:

Marijuana është forma më potente dhe e zakonshme e kanabisit. Marijuana janë gjetet e thara dhe lulët e bimës, e cila pihet si cigare me dorë ose në pipë.

Hashashi ("hash") është rrëshira e tharë e kanabisit, zakonisht në formën e copave të vogla. Përqendrimi i THC në hashash është më i lartë se të marijuana dhe jep efekte më të forta. Ky lloj shtohet në duhan dhe pihet ose konsumohet së bashku me ushqime si biskotat. Vaji i hashashit është një likuid i trashë, në kafe të errët deri në të zezë që ekstrahohet nga kanabis. Vaji i hashashit është forma më e fortë e kanabisit e zakonisht përhapet në një letër cigareje dhe pastaj pihet.

Efektet

Efektet e çdo droge (përfshirë kanabis) variojnë nga personi në person. Sesi kanabis ndikon te një person varet nga shumë gjëra përfshirë masën, peshën dhe shëndetin, gjithashtu, nëse personi e përdor atë më vete apo së bashku me droga të tjera përafërsisht në të njëjtën kohë. Efektet e çdo droge janë, gjithashtu, edhe në varësi të sasisë së marrë. Nuk ka nivel të sigurt për përdorimin e drogës. Përdorimi i çdo droge zakonisht ka rrezik - edhe ilaçet mund të prodhojnë efekte anësore të padëshirueshme. Është e rëndësishme që të bëhet kujdes kur merret çdo tip droge. Dozat e ulëta të kanabisit mund të prodhojnë efekte që zgjasin 2-4 orë pas pirjes. Efektet e oreksit (të ngrënit) zakonisht fillojnë pas 1 ore. Disa nga efektet përfshijnë: Konfuzion; Nervozizëm; Eksitim; Halucinacion-e; Ankh ose panik; Largim nga realiteti; Rënie e kohës së reagim-it;

Ja tri format kryesore të kësaj droge, si veprojnë në sistemin nervor

Cilat janë efektet negative të kanabisit në organizëm

Ndikimi në tru, mushkëri e sistemin imunitar



Paranojë. Përdorimi për një kohë të gjatë i kanabisit mund të ketë shumë efekte te një individ:
Truri: Paaftësi në përqendrim, kujtesë dhe në të mësuar.
Mushkëri: Pirja e kanabisit mund të

rezultojë në një fyt të dëmtuar, astmë dhe bronkit.

Hormonet: Kanabis ndikon në prodhimin e hormoneve. Kërkimi tregon se disa përdorues kanabisit kanë ulje të dëshirës për seks. Cikle jo të rregullta menstrual-e dhe

prodhimi i ulët spermë janë raportuar, gjithashtu.

Sistemi imunitar: ka disa shqetësime se pirja e kanabisit mund të ndikojë në funksionimin e sistemit imunitar (sistemi imunitar).

Shëndeti mendor: Përdorimi i kanabisit, kryesisht përdorimi në doza të mëdha dhe në mënyrë të rregullt, mund të lidhet me një kondicion që njihet si "psikoza e induktuar nga droga", ose "psikoza kanabis".

EFKJET E MENJËHERSHME

- SHFRENIM;
- TË QESHURA SPONTAN-E;
- SJELLJE E QETË DHE REFLEKTIVE;
- PERCEPTIM I INDIKUAR PËR ZHURMAT, NGJYRAT DHE NDJENJA TË TJERA;
- KONFUZION;
- TË MENDUAR DHE MEMORIE E ALTERUAR;
- ANKTH;
- PARANOJË E LEHTË;
- VIZIONE TË ALTERUARA;
- SY TË SKUQUR E TË PËRGJAKUR;
- QETËSIM;
- GJUMË;
- KOORDINIM DHE BALANCIM I REDUKTUAR;
- RITJE E RITMIT TË ZEMRËS;
- PRESION I ULËT GJAKU;
- RITJE OREKS-I.

10 mënyra për të parandaluar sëmundjet kardiovaskulare

Sëmundjet kardiovaskulare të zemrës po përbëjnë një shqetësim edhe në vendin tonë, pasi kanë pësuar një rritje të ndjeshme nga viti në vit. Në shumë raste, krizat e zemrës mund të jenë edhe fatale, madje kanë filluar të shfaqen edhe te të rinjtë. Normalisht që nuk duhen neglizhuar vizitat apo konsultat me mjekun, dhe është i domosdoshëm një stil jetese sa më i shëndetshëm. Më poshtë po japim 10-të këshilla për një zemër sa më të shëndetshme.

1. Hiqni dorë nga pirja e duhanit

Pirja e duhanit është një nga shkaqet kryesore të sëmundjeve koronare të zemrës, kështu që gjëja më e mirë është të hiqni dorë sa më shpejt për një zemër më të shëndetshme. Rreth një vit pasi ta keni lënë duhanin, rreziku për një atak në zemër do të përgjysmohet. Kështu që kërkonin ndihmë dhe këshilla nga mjeku juaj për ta lënë sa më shpejt pirjen e duhanit.

2. Kryeni aktivitet fizik


Në momentin që jeni sa më aktiv dhe merreni edhe me sport, rrezikshmëria e zhvillimit të sëmundjeve të zemrës mund të zvogëlohet, gjithashtu, ndihmon në reduktimin e stresit. Kështu që përpiquni të bëni rreth 150 minuta aktivitet aerobik me intensitet të moderuar çdo javë. Një mënyrë për të arritur këtë objektiv është duke bërë 30 minuta aktivitet në pesë ditë në javë.

3. Menaxhoni peshën tuaj

Duke qenë mbi peshë mund të rrisni rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Mbani një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar, të ulët në yndyrë dhe sheqer, dhe konsumoni sa më shumë fruta dhe perime, të kombinuara me aktivitet fizik të rregullt. Nëse jeni mbi-peshë, provoni planin për të humbur kilogram.

4. Hani më shumë fibra

Hani shumë fibra për të ndihmuar në uljen e rrezikut të sëmundjes së zemrës, madje synoni të konsumoni të paktën 30gram në ditë. Hani fibra nga një shumëllojsh-



mëri burimesh, të tilla si bukë me miell, krunde, tërshëra dhe drithëra të integruara, patate me lëkurat e tyre dhe shumë fruta e perime.

5. Mos konsumoni shumë yndyrë

Në momentin që konsumoni ushqime që kanë nivele të larta yndyre të ngopur, jeni të predispozuar që niveli i kolesterolit në gjakun tuaj të rritet. Për pasojë rreziku që të prekeni nga sëmund-

jet kardiovaskulare, rritet. Kështu që zgjidhni të konsumoni produkte mishi dh qumështi me yndyrë të ulët.

6. Konsumoni fruta dhe perime

Hani një shumëllojshmëri të frutave dhe perimeve në ditë, pasi janë një burim i mirë i fibrave, vitaminave dhe mineraleve. Ka shumë mënyra të shijshme konsumimi, si duke shtuar fruta të copëtuara në drithëra ose duke

përfshirë perimet në salcat e makaronave.

7. Mos e topmoni me kripën

Për të ruajtur presionin e shëndetshëm të gjakut, mos përdorni kripë në tryezë dhe provoni të shtoni më pak në gatimin tuaj. Sapo të mësoheni me shijen e ushqimit pa kripë të shtuar, ju mund ta eliminoni zakonin e konsumimit në sasi të mëdha. Por duhet të kini kujdes për nivelet e larta të kripës në ushqimet e gatshme. Kështu që kontrolloni



|| Mos harroni se alkooli përmban kalori. Pirja e rregullt më shumë se normalja mund të ketë një ndikim të dukshëm në belin tuaj. Përpiquni të mbani kufijtë e alkoolit të rekomanduar ditore për të zvogëluar rrezikun e problemeve serioze me shëndetin tuaj, duke përfshirë rreziqet për sëmundjet e zemrës.

etiketat e ushqimit pasi nuk duhet të ketë më shumë se 1.5gram kripë (ose 0.6gram natriumi) për 100g. Të rriturit duhet të hanë më pak se 6gram kripë në ditë në total, pra rreth një lugë çaji.

8. Hani peshk

Hani peshk të paktën dy herë në javë, duke përfshirë një pjesë të peshkut me vaj. Peshqit si sardelat, toni i freskët dhe salmoni janë një burim i yndyrave omega-3, të cilat mund të ndihmojnë në mbrojtjen nga sëmundjet e zemrës.

9. Pini më pak alkool

Mos harroni se alkooli përmban kalori. Pirja e rregullt më shumë se normalja mund të ketë një ndikim të dukshëm në belin tuaj. Përpiquni të mbani kufijtë e alkoolit të rekomanduar ditore për të zvogëluar rrezikun e problemeve serioze me shëndetin tuaj, duke përfshirë rreziqet për sëmundjet e zemrës.

10. Lexoni etiketën e ushqimit

Kur bëni pazar, është një ide e mirë për të parë etiketën mbi paketimin e ushqimit dhe pijes për të parë sa kalori dhe sa yndyrë, kripë dhe sheqer përmban produkti. Ajo çka përmban ky ushqim dhe se si përshtatet me pjesën tjetër të dietës tuaj do t'ju ndihmojë të bëni zgjedhje më të shëndetshme.

Këshilla

Dëllinja, pastruesi i veshkave dhe mushkërive

Bima shëruese e dëllinjës, e brritur kryesisht në disa zona të Evropës, Amerikës së Veriut e Azisë është e njohur për efektet kurative që prej lashtësisë. Kokrrat e dëllinjës përdoren në medikamente të ndryshme pasi kanë aftësinë të shërojnë një sërë sëmundjesh pasi përmbajnë një acide organike të rëndësishme për trupin e njeriut, gjithashtu, sheqerna natyrale, kalium e kalcium. Dëllinja është ilaç për stomakun e format e ndryshme ulcerore pasi vetëm duke e përthypur ndihmon procesin e tretjes si dhe ka efekte çudibërëse në pastrimin e mushkërive e bronkeve nga infeksionet dhe sekrecionet. Efekti tjetër pozitiv i dëllinjës është vërtetuar në sistemin urinar e veshka. Konsumimi i lëngut që përfitohet nga to, pastron veshkën dhe shëron ciste që shpesh hasen te femrat. Gjithashtu, kjo bimë ndihmon në kurimin e infeksioneve gastrointestinale, infeksioneve të traktit urinar dhe gurët në veshka, madje mund të jetë efektive në luftimin e baktereve dhe viruseve. Përdorime të



tjera përfshijnë trajtimin e diabetit e kancerit. Shpesh vaji esencial i dëllinjës është përdorur për masazhe, në çlodhjen e muskujve të tendosur, parandalon ngërçet dhe tonifikon muskujt. Disa njerëz e përdorin dëllinjën direkt në

lëkurë për plagë dhe për dhimbje në nyje dhe muskuj. Ndërsa në ushqime, kokrra e dëllinjës shpesh përdoret si një piper ndërsa ekstrakti dhe vaji esencial përdoren si përbërës aromatizues në ushqime dhe pije. Por kjo bimë gjen përdorim edhe në

kozmetikë pasi vaji i saj është përbërës i maskave të ndryshme për flokë të shëndetshëm e shumë produkte të tjera.



Konsumoni arra për të ulur presionin e gjakut e për të luftuar sëmundjet nervore

Arrat janë një ushqim perfekt për t'u konsumuar në mëngjes, por veçanërisht na bëjnë mirë për shëndetin dhe madje kanë efekte çudibërëse në kurimin e shumë sëmundjeve. Ato janë burim i pasur i acideve yndyrore omega-3 e shërbejnë dhe si anti-inflamatorë, duke ndihmuar në këtë mënyrë për të ulur rrezikun e presionit të gjakut, sëmundjeve arteriale koronare, hemorragjisë cerebrale. Një sërë studimesh kanë treguar se sa më shumë arrarë të konsumojnë njerëzit, aq më pak të predispozuar janë për të humbur jetën, në çfarëdo lloji moshe, veçanërisht ndaj sëmundjeve të zemrës. Frutat arnore kanë flavonoide si karotenë, lutein, etj., komponentë këto që ofrojnë mbrojtje kundër kancerit, sëmundjeve të zemrës, sëmundjeve nervore, sëmundjes së Alzheimer, dhe atyre virale e infeksioneve fungale. Gjithashtu, arrat ulin ndjeshmërinë ndaj dëmtimit të enëve të gjakut duke zvogëluar aktivitetin e angiotensin (një hormon sistematik që shkakton ngushtim e enëve të gjakut, duke ngritur presionin e gjakut). Por, ato janë dhe një burim i pasur me minerale si mangnez, kaliumi, kalciumi, hekuri, magnezi, zinku, fluori dhe selenium. Kaliumi është një faktor i rëndësishëm që ndihmon në kontrollimin e rrahjeve të zemrës dhe të presionit të gjakut. Fluori nga ana tjetër është një përbërës thelbësor në shëndetin e dhëmbëve tanë. Frutat arnore janë shumë të pasura me vitaminë-E, një antioksidant shumë i fuqishëm që e mban lëkurën të shëndetshme. Madje vlen të theksohet se arrat janë një burim i acideve yndyrore, të cilat ndihmojnë për të ulur nivelin e kolesterolit.



LIBRI



"Nuk është turp të kërkosh magjinë, aq më tepër kur ajo të bën të lumtur. Të këqijat nuk vinë nga magjijtë e bukura"

Nga Fulvia Shtëpani

Regulli strikt vret frymëzimin, ndërsa metoda i merr frymën lirisë (La rigueur tue l'inspiration, la méthode étouffe la liberté (Henri-Frederic Amiel)

Kur lexon librin me tregime "Rrëfej unë, gruaja" zhytesh në një gjelbërim thellësisht marramendëse, në misteret e hapësirave metafizike të pa eksploruara të vetë njohjes, të flirtit me veten që zgjon sensualitetin, të preludeve të gjendjes shpirtërore në prag-dashurinë e papiritur, apo të vetë dashurisë si emocionit më sublim e më kompleks i qenies njerëzore.

Shumica e njerëzve mund të meditojnë deri në një farë niveli, pak janë të frymëzuar, e të rrallë janë ata që i kanë të dyja, thoshte Hugo. Një ndër kënaqësitë që të dhuron ky libër, ndër të tjera, është edhe konstati i këtij postulati hugonian...

Autorja mendon, si Coelho, në mënyrë komplekse se dashuria nuk është vetëm një ndjenjë e madhërishe, por e konsideron atë si art, për të cilin frymëzimi nuk mjafton. Në shkrimet e saj, ajo ka injektuar një dimension ciceronian nëpërmjet raportit të elementëve topike që përfaqësojnë imagjinacionin, dhe elementëve dialektikë me rëndësi kryesore. Ky raport transformon me irracionalitetin e tij, raportin midis filozofisë e retorikës, duke udhëhequr lexuesin drejt një dualizmi botë irracionale-botë racionale, e duke mbështjellë rrëfimin me një vello enigmatike, si për të qëndisur më së miri rrjetin e misterit.

Në teorinë budiste thuhet: "Ne vuajmë për shkak të dëshirës, zemërimit e budallallëkut". Në një sens simbolik, ne jetojmë në një terren të sunduar në mënyrë paradoksale nga pushteti i konvencioneve, i tabuve morale dhe erotizmit të fshehur. Në shumicën e veprave të para nëntëdhjetës, erotizmi si fenomen njerëzor, është trajtuar më shumë si ankth jetësor, si brengë metafizike apo si sprovë e ekzistencës kolektive, sesa si drame e zbulimit shpirtëror dhe lirisë individuale.

Larg nënkuptimeve, në librin "Rrëfej unë, gruaja", jeta i hap krahet ndjesive, dëshirave, madje edhe atyre të castit, vegimi i saj derget në brigjet eposhe, horizonti i saj është sa i thjeshtë e i kap-

shëm, aq edhe mrekullor e i paarritshëm. Ajo flirton në çdo frymë-marrje me dashurinë, pasi e vetmja kornizë që limiton atë, janë perceptimet e tundimet tona, kërshtëria për të zbuluar e provuar, pasi shpirti njerëzor, është një diell i madh rrezet e të cilit depërtojnë çdo gjë e sjellin jetë, energji, lumturi. Jeta është një hezitim i përhershëm ndërmyjet çuditërimet e pyetësimit (Pessoa).

Liria e njeriut (apo e krijimit) varet nga shkalla e përparimit, nga mënyra e të menduarit, të ndjerit, të reaguarit, duke iu afruar sipas raportit midis tyre, më shumë fatalitetit apo providencës. Por më e rëndësishmja, nga të gjitha është mosvënja e kufijve, pasi vetëm një përjetim i tillë i saj, pa kufizime e pa censurë të frymëzimit. Kjo lloj trajtuese motivore e lirisë së imagjinacionit dashuror, mendoj se ishte e nevojshme në letërsinë shqipe. Nëpërmjet personazheve të saj autorja e përcjell më së miri këtë mesazh: "Nuk është turp të kërkosh magjinë, aq më tepër kur ajo të bën të lumtur. Të këqijat nuk vinë nga magjijtë e bukura"

Profesor Cabej, një nga njohësit më të mirë të psikologjisë së popullit tonë, thotë se tipari më i theksuar është rezervimi. Të arrish të shytysh barrierat e këtij rezervimi jetësor e mendor, kërkon kurajë dhe talent për t'iu shmangur subjektivitetit autorial dhe mediokritetit të temave të "vogla" të personit, personalitetit të tij dhe shpalimeve të psikës.

Tiparet post-moderniste përshkojnë veprën në strukturën e saj të brendshme, si edhe në aspektet e ndërtimit të jashtëm, duke dëshmuar jo rregullitë por rregullimin, jo logjikë, po spontanitet të paparashikueshëm, jo raport mimetik me realitetin po liri ekstreme e lojë kapriçioze në konfigurimin e saj.

Rrëfimi braktis strukturat e format gjuhësore formale, duke i dhënë lexuesit një dimension të veçantë, jo vetëm në kuptimin, por edhe në ritmin e ndjekjes së ngjarjeve. Ta kuptosh veprën, do të thotë të bësh një lexim tërjet ku bashkë qëndrojnë shumë mendësia dhe fikcioni, e vërteta dhe misteri. Nuk kemi thjesht një realitet koherent dhe të unifikuar, vepra ngrihet shpesh mbi një monologim-dilogim fragmentar që "ndrydh" deri diku rrëfimin kryesor, por nga ana tjetër, i vë një theks të veçantë synimeve ideore të saj. Ndryshe nga letërsia e mëparshme, ku lexuesit i ofrohen disa ngjarje apo raporte që zbulojnë thelbin e personazhit, të ky libër, autorja na ofron një shumësi pozicionesh, qëndrimesh emocionale të personazheve, që limitojnë përcaktimin e prioritetit të njërmit mbi tjetrin, duke i lënë vend lexuesit të krijtoje idenë e vet. Med-

Puhizë shkronjash aromë gruaje

Për librin me tregime "Rrëfej unë, gruaja", të autores Mimoza Kuchly



një rrëfimi qëndron padyshim në fuqinë dhe në bindshmërinë e vizionit që i jep zërit të brendshëm që flet, të arkitekturës së mendimit që imponohet vetvetiu, duke zbuluar cilësi të reja në hapësirën imagjinare. Qëllimi i tij është që mesazhi i dërguar të lexuesit të pranohet sa më natyreshëm që të jetë e mundur. Personazhet e tregimeve ilustron në mënyrë të përsosur thënien e Kleber Eden-it si kriter vlerësimi, që "personazhi i gjallë" është shpikja më e bukur profesionale. Në tregimin "Pasqyra" autorja integron me mjeshtëri imazhin e pasqyrës që konsiderohet në letërsi si një katalizator poetik, që ofron mundësi narrative pa limit, si një metaforë e privilegjuar e eksperiencës estetike dhe e prezanimit të saj. Zbulimi i botës së brendshme të personazhit kryesor nëpërmjet pasqyrës është kompleks, sepse shtjellimi bëhet nëpërmjet një dinamike alternimi midis pozicionit dhe osmozës. Pasqyra është një objekt polimorf, që i nënshtrohet pranimit të një pluraliteti konotativ, të ndryshueshëm, ku konvergencën identiteti dhe diferenca sipas principit të analogjisë.

Pasqyrimi është nga një anë, dualitet, dublikim, dhe nga ana tjetër unitet, identitet. Ndër të tjera, pasqyra ka veçantësi të funksionit vetëm në praninë e dritës (sadopak dritë), është drita që na lejon të shohim dhe anë më të fshehta dhe kontradiktore të personazhit të tregimit. Ajo është si hëna "objekt që reflekton" dhe "objekt reflektimi" njëkohësisht.

"Ndriçimi" që pret libri, për të pasqyruar gjithë bukurinë e tij është drita që do të derdhi mbi të lexuesit i pasionuar, ose më mirë do të thosha që shkrimi me forcën e tij deduktive e shndërron lexuesin e thjeshtë, në të pasionuar. Ai e vendos atë pa e kuptuar, në qendrën e një graviteti jetësor, ku të gjitha forcat kontradiktore asnjëherë, duke i dhënë mundësinë të shijojë thellësisht, e në paqe me vetveten, magjinë ëndërrimtare të jetës që të bën të lumtur. Libri është një "puhizë" lirie, dashurie, ëndërrimi, që ka pamjen e një mozaik kompleks e të llojllojshëm, i cili na shpaloset me një gjuhë të pastër, të krehur, elitare, gjuhë që të ngop dhe të këndell, sepse ka një përkujdesje të çliruar nga çdo rëndësi, nga çdo influence, nga çdo pushtim pasi autorja është e lirë, është vetvetja. Ajo përdor tërë forcën krijuese e ndjeshmërinë artistike, për të zbuluar psikologjinë njerëzore, dhe paradoksin modern të ekzistencës dhe mendësisë anakronike të kohës, që na ngjan me një para thirrme

ndërgjegjësuere për qenien njerëzore (te "Vegimi", tek "Takim në orën shtatë të mëngjesit" apo tek "Testamenti i mirënjohjes").

Autorja bën përpjekje të guximshme në artin e të shkruarit, ajo zhvesh me fjalë botën e brendshme, nëpërmjet trillimit e originalitetit, topografisë së marrëdhënieve me njerëzit, duke i parë këto të fundit, si dukuri fenomenale sa të natyreshme aq edhe hyjnore. Për autore, bota letraro-artistike është një metaforë e botës reale, njerëzore dhe hyjnore, është flirte i perënditshëm, është tjerja kuptimplotë e sensuale me liriken, e ëndrës me dashurisë, nostalgjisë dhe mallit, është projekti real i atij impulsi jetësor etërnal, që lulëzon në oazin sentimental të botës femërore. Ajo është vazhdimisht në kërkim të një klimë të re etike, kontempore, plot elegancë dhe elokuencë (te Balerina Pariziane), guxon të na drejtojë përmes personazhit të saj drejt tejdukshmërisë lirike të intimes sensuale që ekziston brenda çdo individi, e universit shpirtëror të dashurisë, ku heshtja është zhurma më e fortë e dëshirës, ajo flirton me misionin e gjallimit të jetës, si pjesa më enigmatike e universit njerëzor e shpirtëror, këtij dualiteti psikologjik e filozofik që shpesh mban peng që në fillësë motorin vital të jetës, dashurinë.

Tregimet e këtij libri të mbushin, me sineritet, vetë njohje, freski, delikatesë, dashuri dhe humbje, dyshim dhe forcë për të përballuar e për ta pranuar atë pa egoizëm, sepse na lënë të kuptojmë që dashuria nuk është "njësore" dhe jeta është e mbushur me mrekullitë dashurie. Ata na bëjnë të kuptojmë sa e rëndësishme është të përgatitemi për ta pritur dashurinë "ashtu siç duhet", duke luftuar brenda vetes egoizmat tona më të fshehta, të cilave shpesh-herë kemi frikë të afrohemi e jo më t'i asgjësojmë, pasi ato janë "skoriet" që na infektuojnë ndjenjat, që dënojnë ciklin lumturor të mos pikturohet me të gjitha ngjyrat e ylberit, që na bëjnë të thithim ajër të ndotur nga pesha e paradigmatave dhe e konvencioneve morale.

Libri "Rrëfej unë, gruaja" është një "serenatë femërore" plot hov njerëzor, ku çdo përshkrim ekspresiv, verbal apo ikonografik, është një imazhi që arrin të shndërrohet nëpërmjet frymëzimit në një tempull nga i cili autorja rrezaton transcendencë, duke krijuar një strukturë matriciale origjinale. Në tekstet e tregimeve, me një stil arabeskë e marramendës, të filtruara e të distilluara me magji, fjalët shkasin plot surprizë, ato verbalizojnë dëshirën e pasurojnë tekniken e shkrimit me variacione midis modernes e postmodernes, duke formuar një arsenal të begatë mjesh të zhërvjellëta, që kthejnë formën në një precedim të mesazhit estetik. Personazhet stereotipikë, lundrojnë në një intrige imagjinare e të kalibruar, që zhvendoset me një amplitudë të thellë filozofike përmes zhbërimeve fine të kthiave të shpirtit, deri tek imperativat dialektike, bëjnë që libri të jetë një vitrinë e re e vendit që duhet të zë tregimi në botën letrare. Frymëzimi është kapriçioz, ashtu si era që fryn ku i pëlqen (Henri-Frederic Amiel), ashtu edhe ndjesitë e autores janë të paparashikueshme, shpesh radikale dhe sfiduese, por gjithmonë shëruese...

STUDIMI

“ Përvjetori i Flotës Ushtarake Detare, një vështrim i shkurtër në ngjarje e kohë ”

Nga Zamir Mati

Historia e dragaminave gjermane "Shqipnia" e "Skënderbeg" Jahti "Iliria", pse nuk i mbërriti kurrë Zogut nga Italia

15 gusht 1945-1992 është Flota Luftarake Detare e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e cila ka pasur flamurin e saj, kjo flotë i trashëgoi disa anije Flotës së Republikës së Shqipërisë anëtare e NATO-s, e cila sot mban një tjetër flamur.

Në këtë ditë të shënuar të historisë detare shqiptare është një nder të kujtosh punën dhe detyrën që ka kryer kjo flotë me efektivat e saj detarë dhe oficerë në gjithë jetëgjatësinë e saj dhe në të gjitha njësitë anije, reparte e vendbazime ku kanë shërbyer me sakrificë për mbrojtjen e Atdheut.

Ish-efektivi i Flotës Luftarake Detare, por edhe historia nuk haron edhe dy shkollat e detarisë atë të instruksionit dhe akademisë detare që u mbyll fatkeqësisht vite më parë.

Shkolla të një vendi mesdhetar aq të domosdoshme për mbrojtjen e zhvillimin në të gjitha fushat e detarisë si ekonomike ashtu edhe turistike.

Flota Luftarake Detare kreu detyrat e veta shembullore edhe duke qenë në vijën ndarëse të luftës së ftohtë dhe në një hapësirë detare ku kishte përballë flotat më të rëndësishme të fuqive të mëdha, por edhe të shteteve të afërta e fqinje. I vetmi incident i saj është ai i kanalit të Korfuzit i dënuar pa të drejtë në mënyrë të njëanshme në gjyqin ndërkombëtar të Hagës, incident që me faktet e reja bën fajtor Anglinë, e cila në formacion luftarak, të miratuar nga admiraliati dhe qeveria angleze, shkeli me anijet e saj në formacion lufte ujërat territoriale shqiptare, duke lënë si dëshmi të shkeljes së sovranitetit bashin e anijes "Woltage" të fundosur në fund detin e Gjirit të Sarandës.

Duke shkruar për traditën luftarake detare në shekuj e në 72 vjetorin e krijimit të njërës nga flotat në këtë ditë historike, që për familjen tonë shënon edhe një ndjenjë respekti jo vetëm për babanë, kundëradmiral Abdi Mati, por një nderim edhe për të gjithë efektivat dhe figurat e njohura që shërbyen me atdhedashuri, sakrificë e vetmohim në Flotën Luftarake Detare.

Në rrugën historike të FLD, e krijuar më 15 gusht 1945, kujtohen me respekt figurat e njohura që shërbyen në këtë Flotë, Abdi Mati, Mark Plani, Teme Sejko, Hito Çako, Azis Hasa, Xhemal Shani, Shefqet Pinar, Stavri Çika, Shaqir Kapexhiu, Hajdar Aranitasi, Kiço Gjiko-pulli, Ziqiri Mero, Shemsi Leka, Pali Carapuli, Dhori Jorgji, Bedri Gjergji, Qamil Poda, Dashamir Ohri, Muharrem Llullolli, Shyqyri Çuka, Spiro Kote (Hero i Popullit) Aleko Pojani, Petrit Myftu, Beqir Gërbi, Skënder Doçi, Besnik Rizvani, Ndue Jaku, Fitim Halili, Robert Bali, Vladimir Beja, Kudret Çela, Petrit Hysi, Daut Meta, Ethem Shkëmbi, Tahir Hoxha, Ylber Sevran, Skënder Spahivogli, Pirro Tushi, Fatosh Voshtina, Viktor Pashko, Shezai Osmani, Vangjel Nano, Seit Jonuzi, Ylli Lika, etj.



1925

Kjo flotë, e njohur si Flota Luftarake Detare e Republikës së Shqipërisë, e cila ka datën e saj simbolike të krijimit më 15 gusht 1945, nuk mohan asnjë vlerë të krijuar më parë në historinë e flotave luftarake detare, edhe datën (25 dhjetor 1925) që shënon vetëm mbërritjen e dragaminave gjermane të klasit FM 1 me emrat "Shqipnia" dhe "Skënderbeg". Ato iu blenë Italisë fashiste nëpërmjet një transakcioni të dyshimtë nga një bankë rumune. Gjermanisë nëpërmjet Traktatit të Versajës i ishte ndaluar shitja e armëve mbas luftës së parë botërore. Krijimi i komandës së Flotës së Republikës Shqipërisë më 24 qershor 1928 me komandant kapitenin e rangut të dytë të Marinës Mbretërore Italiane. Është një datë dy vjet më vonë se data 25 dhjetor 1925 e mbërritjes së

anijeve (dragamina patrulluese të tipit FMI gjermane të luftës së parë botërore). Në shkrime të ndryshme me ngjyra politike dhe mohuese për ditët e tjera, quhet dhe dita e krijimit të Flotës Detare, duke mohuar që gjitha datat e shënuara, ngjarjet dhe dëshmitë e flotave të tjera, të cilat përbëjnë traditën luftarake detare edhe kur ato kanë një organizim, funksion luftarak, njësi dhe anije në një numër të konsiderueshëm dhe jetëgjatësi, siç është Flota Luftarake Detare e krijuar më 15 gusht 1945. Po kështu, duke respektuar në parim dhe koncepte të drejta historike, data 15 gusht 1945 nuk mohan as datat e mëparshme që njihen, as dhe përpjekjet e mbretit Zog si për përdorimin prej tij të jahtit "Aurora" të rikonstruktuar për Musolimin, apo joshja për të blerë jahtin "Iliria" që nuk iu dorëzua asnjëherë,

1924, Flota e Mbretërisë së Zogut deri në 1938, Flotiljet e pushtimit italian, Flotilja e pushtimit gjerman, Flota e Republikës Popullore të Shqipërisë, Flota e Republikës së Shqipërisë anëtare e NATO-s.

Të gjitha këto fakte historike në shekuj dëshmojnë për traditën luftarake detare shqiptare dhe zhvillimin e tyre në detet Adriatik dhe Jon përballë flotave më të njohura të të gjithë historisë detare botërore nga flotat homerike, romake, venetiane, të kryqëzatave, malteze, papale, osmane, franceze, angleze, gjermane, austro-hungareze, etj.

Mbas Luftës së Dytë Botërore historia dëshmon se Flota Luftarake Detare e krijuar më 15 gusht 1945 ishte në gjithë jetëgjatësinë e saj dhe në hapësirën detare të MESDHEUT e veçanërisht të detit Adriatik e Jon përballë flotave të superfuqive, asaj të Royal Navy të Anglisë, të U.S.A-s, të flotave të Italisë, Greqisë, Jugosllavisë, Flotës së 6-të amerikane, flotës sovjetike të Detit të Zi, të U.R.S.S-së dhe duke qenë përballë këtyre flotave në fuqirin me të nxehtë të luftës së ftohtë ajo plotësoi detyrën e saj në mbrojtjen e Atdheut pa incidente dhe me një profesionalizëm të admiruar.

Përkujtimi i ditëve të shënuara të traditës sonë detare do të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj tradite jo vetëm në fushën ushtarake dhe të mbrojtjes së demokracisë, por edhe të ekonomisë e sidomos të turizmit.

"Pjesë nga Libër Albumi në proces për FLD"

EKSPOZITA, "DHIMITËR VANGJELI, NJË ARKIV I SHPËTUAR"



Në foto: Dhimitër Vangjeli

Në kuadër të kalendarit të përbashkët Shqipëri-Kosovë 2017, Ministria e Kulturës së Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe Bashkinë Kolonjë organizojnë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë në datat 24 - 30 nëntor 2017 ekspozitën "Dhimitër Vangjeli, një arkiv i shpëtuar dhe i dokumentuar". Dokumentimi shpëton thesare të trashëgimisë kulturore. Emri i Dhimitër Vangjelit është pothuajse i panjohur në historinë e fotografisë shqiptare, edhe pse fotot e tij i gjejmë të pasqyruara në botimet më të rëndësishme që në vitet '20-të, por mjerisht pa përmendur autorin. Në regjistrat e kohës së fillim shekullit të 20-të, Kolonja nuk ka të evidentuar fotograf dhe Dhimitër Vangjeli ishte i regjistruar si sheqerxhi. Në një foto të ruajtur, jo nga fondi i negativëve, por e ristampuar, gjejmë tabelën e dyqanit, ku shkruhet: HEMBELTORE. OREN-DREQES DHE FOTOGRAFIA. DIMITER K. VANGJEL. Profesioni e ushtroi prej disa dekadash, u kujdes dhe e ruajti me dashuri për

të na e lënë si trashëgimi të vyer e të papërsëritshme.

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore dispononte të dhëna se në fondin e Muzeut Historik Ersekë në fundin e viteve '60 të shekullit të kaluar, ishin depozituar për ruajtje rreth 1300 negativë në xham të arkivit të fotografit kolonjar Dhimitër Vangjeli. Fondi i negativëve u ishte blerë familjarëve të fotografit dhe ishte marrë në ruajtje nga Bashkia Kolonjë, pasi rrejtikonte shtatërrimin pas vdekjes së Dhimitër Vangjelit, por asnjëherë nuk u regjistrua si fond në inventarët e muzeut apo bashkisë, askush nuk e vlerësoi apo studioi, por mbeti i mbyllur në një valixhe të vjetër puar, gjejmë tabelën e dyqanit, ku shkruhet: HEMBELTORE. OREN-DREQES DHE FOTOGRAFIA. DIMITER K. VANGJEL. Profesioni e ushtroi prej disa dekadash, u kujdes dhe e ruajti me dashuri për

QKIPK, në përmbyshje të mis-

ionit madhor për krijimin e Inventarit Kombëtar të Pasurive Kulturore bëri të mundur zbulimin, inventarizimin dhe regjistrimin në databazën kombëtare të Fondit të rrallë të fotografive negativë në xham nga krijimtaria e fotografit Dhimitër Vangjeli, si një nga personalitetet e artit të fotografisë të realizuar në Shqipëri. Tashmë mund të themi se ky fond është i shpëtuar dhe i sigurt dhe i përcillet publikut jo më si një legendë urbane.

Albumi "Kolonja përmes fotografisë së Dhimitër Vangjelit" do të krijojë për publikun shqiptar dhe të huaj mundësinë e njohjes, vlerësimit dhe popullarizimit të kësaj pasurie kulturore, si pjesë shumë e rëndësishme për jetën qytetare të fillim shekullit 20-të, në një nga qendrat e zhvillimit të kulturës shqiptare për atë periudhë.

Opinion i Ditës

Nga Liliana Hoxha

(Vijon nga faqja e parë)

... Nuk mund të ndodhte ndryshe për pritshmëritë që ofrojmë si komb, për mosmarrëveshje midis nesh, sidomos për dimensionet jo vetëm prej miti për mirë apo për keq, por deri edhe mistike që patën të dy. Gjë që, me sa duket, nuk mund të ndodhë përveç se një herë në 500 vjet, sado ritëm fatal ky i nënshtrimit ndaj të keqes që prodhojmë, njëkohësisht si ritëm shprese, si dinamikë të brendshme kur kombi të vendosë të çelë sytë, për të dalë nga asimilimi këtë radhë prej injorancës e korrupsionit që dikton pushtimi shqiptar ndaj shqiptarëve. Kështu që asgjë nuk mund të më intimidojë më në raport me Enver Hoxhën se sa somnambulizmi i shqiptarëve. Po të kthehemi në temë.

Sërish pata keqardhje për produktin shqiptar se sa atë të CIA-s për Enver Hoxhën. Thënë shkurt, mbrëmë dokumentari i "ABC News" për sekretet e Enver Hoxhës lëvruar nga CIA, ishte një ripërsëritje e dokumentarit të Fevziut miksuar me të ashtuquajtura dokumente të CIA-s të deklasifikuar, nga të cilat nuk mund të merrje asgjë për t'u bazuar, si superficiale e të mangëta nga serioziteti, pa asnjë fakt të vrojtuar e jo më të vërtetuar nga agjentë apo bashkëpunëtorë të mirëfilltë të CIA-s të pajisur me kompetencat që i takojnë këtij shërbimi autoritar. Ishin dëshmi thashethemesh të individëve të rëndomtë rrethorë e të vetvullneshëm për të dëshmuar ashtu siç ju kërkohet të hiqet vallja. Kjo gjë sinjorisht më ka befusuar sa kuptova që nuk është qëllimi i CIA-s të lëvrojë këto hedhurina për investigimin e saj të posaçëm për Enver Hoxhën, por janë kërkuesit e thërrimeve që mund të gjenden lehtë si të pavlera ndaj edhe të deklasifikuar. Interpretimi i të cilave CIA-s nuk i intereson fare, pikërisht sepse nuk ka qenë qëllimi i saj të përdorë këto hedhurina për deri sa s'ia doli në qëllimin që kishte për të sajuar perversitetin seksual të Enver Hoxhës ndaj të cilit vetë shqiptarët do të ngriheshin kundër tij. Gjithsesi nuk është qëllimi im të merrem me dokumentacionin e pavlerësuar nga vetë CIA, por me shfrytëzimin e abuzimin që bëjnë në emër të CIA-s kërkuesit shqiptarë në këmbëngulje për vdekjen natyrale të Enver Hoxhës e në qëndrimin aq sa mund por Ramiz Alisë. Skemë e diktuar në kohën përkatëse nga ai vetë e Nexhmije Hoxha. Vdekja natyrale e Enver Hoxhës i intereson çdo antishqiptari në thelb i tillë sado shqiptar qoftë, për të zvogëluar dimensionet e mitit. Por drejtpërsëdrejti i intereson Nexhmije Hoxhës e diktuesve të saj të shërbimeve ruso-sllave. Siç është insistimi për vdekje natyrale në qëndrimin zyrtaro-publik ashtu ka qenë kërcënimi me vetë jetën time duke shpëtuar shumë herë për çudi, prej saj në gojën e ish-sigurimave: Fol çfarë të duash, vetëm për vdekjen e Enver Hoxhës mos fol!!!! CIA-s, vdekja e tij që do të përfshinte vetëm disa vjet, nuk i



ka interesuar. Për vetë ndryshimet gjeopolitike në Ballkan e sidomos të luftës së ftohtë, Enver Hoxha ishte faktor stabiliteti në rajon kundër KGB dhe UDB. Pra, jetëgjatësia e tij i interesonte asaj. Por nga ky interes më se i qartë nuk mund të rrjedhë deklarata e përdorur nga dokumentari në emër të saj për vdekje natyrale të Enver Hoxhës. Meqë CIA s'ka qenë e interesuar për vdekjen e tij ajo nuk mund të bëhet mbulim i shërbimeve të huaja kundërshtarë të luftës së ftohtë. Edhe informacioni i CIA-s për shëndetin e Enver Hoxhës s'të çon asgjëkund, çka provon mosinteresimin real të saj për vdekjen e tij. Por për dikë që ka studiuar çështjen, aty këtu, gjen përkime të rastit, por të fuqishme. Ndaj më vletën dy argumente shumë të rëndësishëm në vërtetimin të akuzës time për vrasjen e Enver Hoxhës nëpërmjet mjekimit. Në dokumentet e CIA-s del që në 1976 kardiologu pranë E.H., Nikolla Shurbani deklaroi që ai vuante lehtë nga problemet kardiake e

qarkullimit të gjakut. Nikolla Shurbani e kam njohur personalisht. Ishte më kompetent e ndërkaq më i ndershmi pranë shërbimit të Enver Hoxhës. Bie në sy që Shurbani nuk e ka bërë alarmante shëndetin e tij në 1976 kur Nexhmija e mjeku personal i tij Kalo që në '74 e kishin futur në karantinë me psikozën e të sëmurit rëndë ndaj atij dhe ndaj nesh, por sekret për popullin. Shurbani u zhduk. Protagonistët nuk i zë lapsi i CIA-s, sepse ajo nuk është marrë me atë problem. Gjithashtu, përmendet një mjek italian (Zorxoli) apo disa japonezë që kanë vizituar Enver Hoxhën. Përveç mjekut francez Miliez për të cilin CIA s'kishte hollësi, asnjë nga këta nuk ka vizituar Enver Hoxhën. Duken shumë si pista dizinformuese për vetë CIA-n. Gjithmonë në kësi raste për njerëz që janë marrë me studimin e çështjes mund të gesh prej rrjedhjes së informacionit në dukje të parëndësishëm, por që përkon me faktin e vërtetuar nga Auron Tare që zbulimi italian ka

pasur që në vitet '70 dosjen reale shëndetësore të Enver Hoxhës, e mundshme kjo vetëm nëpërmjet njerëzve më të afërt d.m.th. doktorit më të afërt apo familjarëve të tij. Në krahuin tjetër të luftës së ftohtë të atyre viteve, shërbimet përkatëse fshehin, kërcënojnë, vrasin për zbulimin e vdekjes së Enver Hoxhes. Nderkaq që nxjerrin në gojën e CIA-s të pa interesuar që Enver Hoxha pati vdekje natyrale. Askush nga ne shqiptarët që veprojme me fjalë e penë, duke filluar që nga unë, producentët e dokumentarit apo emra që përmenda më lart nuk kanë interes as qëllim e as këllqë të merren, të analizojnë apo përgojnë këto shërbime në fjalë. Çështja është sa shqiptarë jemi në të vërtetë se antishqiptarizmi ushqehet madje diktohet në mënyrë të pandjeshme po të jesh i verbër e për më keq po të jesh i interesuar, sërish mund t'ia dalësh duke pasur alibi opinionin personal. Mbetet gjithmonë çështje ndërgjegjeje: Sa është secili në thelb shqiptar.

Shqiptarët vallëzojnë mbi të keqen e tyre

HOROSKOPI

DASHI

Një Hënë dembele sot nuk ju ndihmon aspak. Keni ndjesinë sikur jeni në një zonë të izoluar dhe çdo gjë ndodh larg. Nuk arrini të merrni një pozicion mbi asgjë pasi ju duket sikur duhet të keni kujdes nga ndonjë kurth apo grackë.

DEMI

Realizimi i ëndrrave tuaja mund të bëhet i thjeshtë, sot që Hëna në harmoni me Neptunin dhe Plutonin ju përkrah me intuita të mira dhe mbështetje të fortë. Dëshira për të dashuruar ju shtyn të kërkoni një bashkëpunim të madh me partnerin.

BINJAKET

Të hutuar dhe të çorientuar do humbini gjallërinë e zakonshme dhe do nervozoheni për çdo problem të vogël që ju paraqitet, në shtëpi apo jashtë. Nëse partneri ju shfaqet pak i menduar, përqipni mos ta shqetësoni dhe t'i jepni kohë të reflektojë.

GAFORJA

Ditë e shkëlqyer ku duket se do mbi-zotërojë humori i mirë, megjithëse me personat me humor të rëndë si puna juaj, nuk kuptohet asnjëherë se si do përfundojë! Çifti Hëna-Neptun ju dhuron intuitë të shkëlqyer, të cilën duhet të dini t'i jepni rëndësinë e duhur.

LUANI

Mungesa e rasteve që lakmoni ju bën të ndjeheni shumë të shqetësuar. Më mirë rritni dhe shikoni dhe lini të tjerat të marrin vendimet e rëndësishme. Çështjet e biznesit kërkojnë vëmendje të jashtëzakonshme, mos u merrni me gjëra sipërfaqësore.

VIRGJERESHA

Nëse keni një problem për ta zgjidhur me partnerin, është mirë që ta përbaltoni me gjakftohtësi dhe pak sens humor. E qeshura të ndihmoni! Ndonjë tension i lehtë në nivelin emocional nuk do jetë i mjaftueshëm për ta bërë ditën më pak produktive.

PESHORJA

Një koleg në punë mund t'ju ndihmojë të kuptoni dhe të zgjidhni disa çështje që ju shqetësojnë në ambientin familjar. Duke përdorur diplomacinë dhe afatin kohor, do mbyllni një çështje në favorin tuaj.

AKREPI

Ditë e shkëlqyer me të gjithë yjet në favor që përfordojnë emocionet. Pak fjalë, por shumë dashuri, sot do ndjeheni të plotësuar në atë që kërkoni! Aktivitetet krijuese në nivelet më të mira: muzika, piktura ose fotografia janë metodat më të mira për të shprehur gjendjen tuaj.

SHIGJETARI

Bëni një hap jashtë problemeve dhe mbani telashet në distancë. Ajo që ju shqetëson nuk ju tremb më nëse bëni konfrontimin e duhur. Nervozizmi dhe paqartësitë që keni, do ndikojnë shumë në humorin e sotëm.

BRICJAPI

Do jeni të kënaqur nga rezultatet e arritura në fushën profesionale. Efikasiteti juaj do vlerësohet edhe nga ata që nuk prisni. Miq bujarë dhe të besueshëm do ju udhëheqin duke ju dhënë këshillat e duhura.

UJORI

Të shtyrë nga kurioziteti, do lëvizni që të jeni të pranishëm në çdo situatë, megjithatë përqipni të shmangni pyetjet e tepërta. Momente nostalgjie por do e merrni vetëm shumë shpejt, diçka do ndryshojë, intuita juaj nuk gabon!

PESHQIT

Në çift me Neptunin, Hëna në shenjin tuaj është një ndihmë e shkëlqyer. Humori i mirë, ndjeshmëria dhe shpirti i aventurës do pasurojnë raportin në çift. Ndëqin frymëzimin artistik. Puna juaj krijuese është e dallueshme edhe në gjërat më të zakonshme.

Katowica

Apologjia ruse dhe serbe për kasapin e Bosnjës

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Ajo që ndodhi në ish-Jugosllavi kishte nevojë për një Nuremberg të ri dhe për një Potsdam të ri.



... krime kundër njerëzimit, është një mesazh i madh juridik, historik dhe moral ndërkombëtar se drejtësia mund të vonojë, por nuk harron, dhe se ata udhëheqës dhe shtete, që ëndërrojnë përsëritjen e luftërave në ish-Jugosllavi, duhet ta dinë se do të përballen me drejtësinë. Në kohën që gjithë bota demokratike përshëndeti vendimin e Hagës, nuk mund të mos bëjë përshtypje nga pikëpamja morale, juridike, diplomatike dhe historike, ajo apologji e mjerë zyrtare, që u ngrit në Rusi dhe në Serbi për përbindëshin e Bosnjës. Në datën 23 nëntor zëdhënësja e MPJ të Rusisë, Maria Zakharova, bëri një deklaratë emfatike në mbrojtje të kriminelit famëkeq serb të luftës dhe me sulme e akuzua ndaj gjykatës Ndërkombëtare të OKB, pse dënoi kriminelin. Ja çfarë thotë deklaratata zyrtare e MPJ të Rusisë: "Vendimi i dënimit të Ratko Mladiciçit është vazhdimi i kursit të politizimit dhe të paragjykitimit, që ka dominuar veprimtarinë e gjykatës. Interpretimi antiserb i gjykatës për ngjarjet tragjike të viteve '90 në ish-Jugosllavi, në fakt, e gërryen procesin e rikthimit të besimit reciprok në Ballkan". Kërkesa ruse është njësoj sikur në mbarimin e luftës së dytë botërore të faleshin dhe të mos dënoheshin komandantët ushtarakë nazistë në emër gjoja të procesit të pajtimit në Europë. MPJ e Rusisë harron se pajtimi në Europë u bë pikërisht mbi bazën e dënimit të ashpër të kriminelëve të luftës.

Moska lëshoi në një fushatë masive të propagandës e saj ndërkombëtare në mbrojtje të kasapit të Bosnjës, duke arritur në nivelin e mjerueshëm, ku as propaganda sovjetike nuk është ulur, duke shpërndarë idiotizma të tilla se "Mlladiçi ka mbrojtur serbët nga xhahadi". Propaganda ndërkombëtare ruse, duke kapërcyer kufijtë e qdo fantazie historike, po heroizon edhe po bën apologjinë edhe të kasapit të Ballkanit, Millosheviç, duke shpërndarë nëpër botë idiotizmat se forcave ushtarake serbe gjatë luftës në Kosovë u ishin dhënë dokumente, që flasin për ligjet humanitare ndërkombëtare, se Millosheviçi kishte urdhëruar të mos lejoheshin forcat paraushtarake serbe të vepronin në Kosovë, se Millosheviçi kishte dhënë porosi që forcat serbe të mbronin pjesëtarët e kombeve dhe të etnive të tjera, dhe se fajin për gjithçka e kishte NATO, e cila "ka bërë luftë bërthamore të intensitetit të ulët kundër Serbisë".

Ky kurs zyrtar i Rusisë për apologjinë e krimeve kundër njerëzimit, që Serbia ka kryer kundër popujve joserbë, nuk ka asnjë skrupull, as moral, as historik dhe as diplomatik. Duke mbrojtur kriminelët ndërkombëtarë serbë si Millosheviçi, Mlladiçi, etj., Rusia mbron atë politikë kriminale të Beogradit ndaj popujve joserbë, që e ka mbështetur fort në kohën kur u zbatua. Këto qëndrime antitorale inkurajojnë forcat radikale ultra nacionaliste në Serbi për të mbajtur pushtetin, sepse me ato forca Moskë garanton ndikimin e vet dhe kontrollin në Serbi. Forcat radikale nacionaliste serbe, pasues të Millosheviçit dhe të Mlladiçit, janë sot garantuesit e varësisë së Serbisë nga Rusia dhe BE. Apologjia e kasapit të Bosnjës është vazhdimi i kursit zyrtar të Rusisë, e cila ka qenë mbështetësjë kryesore e Serbisë dhe e bandave ushtarake serbe në Bosnjë-Hercegovinë me armë, para dhe me mercenarë rusë në kohën e luftërave të

viteve '90. Nuk të habit as apologjia e Serbisë zyrtare, ku presidenti Aleksandër Vuçiç reagoi duke deklaruar në 22 nëntor se "Vendimi i gjykatës është një vendim i pajustificuar". Nuk mund të mungonte në apologjinë e shëmtuar për krimin Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe, e cila ka bekuar të gjitha luftërat, masakrat dhe gjenocidin serb kundër popujve joserbë, dhe iu bashkua korit profasist me deklaratën "vendimi për dënimin e Mlladiçit është punë e djallit". Qëndrimi zyrtar serb është vazhdim i politikës së shtetit dhe të qeverive serbe, të cilat e fshehën 16 vjet me radhë kriminelin e luftës Mlladiç, kur ai u shpall nga Haga në kërkim ndërkombëtar,

Kjo është garnitura e grimuar serbe, me të cilën na është premtuar se do të krijojmë familjen e lumtur ballkaniko-perëndimore, ku Shqipëria, e sëmurë e përjetshme e internacionalizmit, do të gjejë fatin e vet të shumëpritur historik.

Disa mësimë dalin e duhet të dalin nga këto zhvillime negative, ku shtete si Rusia dhe Serbia rreshtohen zyrtarisht në mbrojtje të krimeve dhe të gjenocidit të kryer nga ushtria dhe shteti serb në vitet '90' në Bosnjë, në Kosovë dhe në Kroaci.

Së pari, duhet thënë që apologetët e sotëm të kasapit të Bosnjës, Rusia dhe Serbia, janë protagonistët e politikës millosheviçiane të krimit më të madh kundër njerëzimit, të kryer pas luftës së dytë botërore kundër popujve në Europë.

Aleksandër Vuçiç ka qenë ministër i qeverisë së Millosheviçit, zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Jashtëm Ivica Daçiç ka qenë ministër i qeverisë së Millosheviçit, kryetarja e sotme e parlamentit Maja Gojkoviç ka qenë ministre dhe zëvendëskryeministre e kabinetit të Millosheviçit. Ministri i sotëm i mbrojtjes i Serbisë, Aleksandër Vulin, ka qenë këshilltari besnik i gruas së Millosheviçit, një arkitekt e konflikteve në ish-Jugosllavi. Ministri i mbrojtjes Vulin shpall hapur se është admirues i asaj që ka bërë Millosheviçi, dhe para pak kohësh deklaroi publikisht se ai "ka luftuar sëbashku me ish-presidentin Millosheviç për ideale të rëndësishme dhe të çmuara dhe sa të jem gjallë do të vazhdoj në këtë rrugë". Dhe nuk është rastësi që të gjithë këta udhëheqës, të dalë nga uniforma e Millosheviçit, kanë të përbashkët se janë pro-rusë të fandaksur.

Kjo është garnitura, që qeveris sot Serbinë, kjo është garnitura që gjoja po bën kthesën dhe po vesh kostum europian. Kjo është garnitura e grimuar serbe, me të cilën na është premtuar se do të krijojmë familjen e lumtur ballkaniko-perëndimore, ku Shqipëria, e sëmurë e përjetshme e internacionalizmit, do të gjejë fatin e vet të shumëpritur historik.

Duke analizuar apologjinë e Rusisë dhe të Serbisë për kasapin e Bosnjës dhe për kasapin e Ballkanit, nuk mund të mos humlotosh për klimën ndërkombëtare dhe shkaqet favorizuese të kësaj apologjie. Me keqardhje duket pranuar se një pjesë të fajit për këtë situatë të papëqyeshme diplomatike e morale e ka edhe BE. Ka qenë gabim i madh i BE, e cila nuk e trajtoi krimin shtetëror serb në njësi si krimin shtetëror nazist. Unë kam shkruar në librin tim "Serbia kundër Serbisë. Analizë e një gjysmë revolucioni të lënë përgjysmë", (Tiranë, 2004), se ajo që ndodhi

në ish-Jugosllavi kishte nevojë për një Nuremberg të ri dhe për një Potsdam të ri: "Konkludimi historik i konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi e kërkonte një Potsdam të ri, ku Serbisë dhe udhëheqës serbë t'i viheshin detyrime dhe kushte të tilla ndërkombëtare, që rajoni dhe Europa të sigurohej se asnjë udhëheqës dhe asnjë udhëheqës i ardhshëm serb nuk do të guxonte të ringjallte ambicinet nacionaliste dhe politikat destabilizuese dhe të përgjakshme të ish-presidentit Millosheviç". (fq.75).

Kjo do të thotë që ata, të cilët me shtetin dhe ushtrinë e tyre shkaktuan masakrat dhe gjenocidin në ish-Jugosllavi, duheshin dënuar me atë shpëjtësi dhe rigorozitet si kriminelët nazistë të luftës. Kjo do të thotë që Serbia dhe makina ushtarake serbe e agresioneve duhet të ishte ngarkuar me penaltitë dhe Serbia të ishte detyruar të paguante reparacione për shkatërrimet, masakrat dhe krimet, që u shkaktoi popujve joserbë. Kjo do të thotë që për kriminelët ndërkombëtarë serbë të luftës duhet të ishte krijuar klima mbyhtëse, që të mos guxonte shtet apo qeveri, që t'i merrte në mbrojtje, siç nuk guxon sot qeveri apo shtet të marrë në mbrojtje nazistët 72-vjet mbarim të luftës.

Diplomacia europiane bëri gabimin e madh që, në ngutjen për të vendosur paqen në rajonin e ish-Jugosllavisë, shpiku të ashtuquajturin teori të simetrisë së fajit, sipas së cilës të gjithë, edhe agresori serb, edhe viktimat joserbe, kishin njësoj faj ndaj njeri-tjetrit, dhe kjo teori padyshim shfaqësoi dhe trimëroi kriminelët. Kjo teori është bërë platforma zyrtare e Serbisë për të mbrojtur krimet e saj dhe kriminelët ndërkombëtarë të luftës.

BE bëri gabimin që nuk reagoi kur ish-anëtarët e qeverisë së Millosheviçit morën zyrtarisht pushtetin në Beograd me ardhjen në fuqi të Tomislav Nikoliciçit, Aleksandër Vuçiçit, Ivica Daçiçit, etj. Madje kësaj garniture qeveritare i dha statusin e shtetit kandidat dhe i hapi bisedimet e pranimit në BE. Brukseli po bën gabimin, që nuk po reagon ndaj tendencës së rrezikshme qeveritare në Beograd për rehabilitimin dhe rifutjen në institucionet shtetërore të kriminelëve serbë të luftës. Kriminelët ndërkombëtarë të luftës si Lazareviç, Dikoviç, Shahinoviç etj. janë përsëri në podiume e ndërthi dhe të pushtetit. Prestigjiozja amerikane "Nju Jork Tajms" shkruante në 23 nëntor: "Qeveria në Beograd është madje duke mirëpritur kriminelët e dënuar të luftës dhe aleatët të Sllobodan Millosheviçit". Kurse AFP shkruante në 24 nëntor se "Në Beograd njerëzit e afërt me njeriun e fuqishëm të kohës së luftës, S. Millosheviç, po kthehen në postet e larta".

Kjo që po ndodh aktualisht, kur Serbia dhe Rusia afishojnë publikisht apologjinë e kasapit të Bosnjës dhe të kasapit të Ballkanit, duhet të bëjë që si BE, ashtu dhe shtetet e rajonit, të rivlerësojnë me mendje të kthjellët lidhur me marrëdhëniet dhe llojin e bashkëpunimit me Serbinë. Nuk mund të ketë as integrim real europian dhe as të ashtuquajtur integrim ballkaniko-perëndimor me drejtuesit e Serbisë aktuale, që janë kopje e kohës së Millosheviçit. Shtetet e të ashtuquajturit Ballkan Perëndimor duhet të ruhen nga miopia politike dhe diplomatike, që i pengon të shohin përtej retorikës dhe ahengjeve ballkanike.

Nuk kuptohet përse disa qarqe në Tiranë dhe në Prishtinë ende e sugjestionojnë veten me lutjen "Bëje zot ëndërr", kur Serbia po i mpreh dhembët përditë për tokën shqiptare, që quhet Kosovë.

Kategoria superior luan ndeshjet e së dielës. Nuk ka surpriza nga ekipet udhëtuese

Kamza dhe Vllaznia sigurojnë fitore në shtëpi

Luftëtari dhe Lushnja mbyllin tabelën e renditjes



Jeton Selimi

Kamza vuan, por siguron një trepikësh të vlefshëm ndaj Lushnjës. Të besuarit e Ramadan Ndreut e gjejnë veten shumë shpejt në disavantazh, kur në minutën e 7-të një kombinim mjaft i bukur mes Sefës dhe Cankës, i krijon këtë fundit mundësinë e guajtjes dhe sulmuesi lushnjarr nuk fal duke mposhtur Halilajn. Megjithatë, të zotët e shtëpisë nuk demoralizohen dhe 9 minuta më pas është Sebino Plako që gjen një trajktore fitimtare në ekzekutimin e goditjes së dënimit, që sjell baraspeshën. Por Kamza do ta mbyllë pjesën e parë në epërsi, ndërsa Meto shkakton autogol pas devijimit të Raçicit. Rezultati nuk do të ndryshojë deri në fund dhe Kamza konsolidon edhe më tepër pozitën e saj me 20 pikë në vendin e katërt, ndërsa Lushnja mbetet në kuotën e 5 pikëve.

Vllaznia gjen më në fund fitoren ndaj Luftëtarit në shtëpi, sukses që i mungonte prej 5 vitesh. Skuadra e Ernest Gjokës çel rezultatin në "Loro Boriçi" me anë të Gilman Likës, harkimi në zonë i të cilit nga goditja e dënimit, devijohet lehtë nga Ramadanit e përfundon rrjetët. Megjithatë Luftëtari do të barazojë në të 42-ën, dhe do të kemi sërish gol me goditje dënimi, teksa Dejvi

| SUPERLIGA | |
|----------------------|-------|
| JAVA E 12-të | |
| TË SHTUNËN | |
| Laçi-Kukësi | 0-1 |
| Flamurtari-Teuta | 0-0 |
| TË DIELËN | |
| Kamza-Lushnja | 2-1 |
| Vllaznia-Luftëtari | 2-1 |
| TË HËNËN | |
| Partizani-Skënderbeu | 17:00 |



Bregu mposht Selimajn nga distanca. Portieri shkodran e prek topin, por nuk mund

ta devijojë nga rruga drejt rrjetës. Në fillimin e pjesës së dytë janë miqtë nga

Gjirokastra që i afrohen golit në disa momente. Bregu në të 57-ën mund të kishte bërë dëm me guajtjen e tij, por nuk i jep topit harkun e duhur. Në minutën e 68-të Luftëtari do të shënojë me Lamcen, por i saktë sinjalizimi i vijërojtësit për një pozicion të parregullt. Luftëtari këmbëngul dhe në 71-ën diagonalia e rreptë e Abazajt do të gjejë grushtimin në këndore të Selimajt. Aksioma

më e famshme në futboll do të përsëritet sërish në minutën e 83-të, kësaj radhe në favor të Vllaznisë. Hajdari gjen fundoren dhe harkon në zonë. Gilman Lika shfaqet i pamarakuar në shtyllën e dytë dhe gjuan fluturimthi mes këmbëve të Ruçit për golin e fitores së shkodranëve, që ngjiten në kuotën e 12 pikëve, duke lënë pas shpine pikërisht Luftëtarin, që mbetet i parafundit me 9 pikë.

NË KRYEQYTET

Sot, superndeshja Partizani-Skënderbeu

Partizani-Skënderbeu është sfida më joshëse e javës së 12-të në futbollin shqiptar. Pas fitores së arritur kundër Kukësit në transfertë të kuqtë kërkojnë vazhdimësinë në rezultate, përballë kanë një skuadër që po kalon një moment magjik, por sfida kundër Dinamo Kiev ka konsumuar fizikisht jo pak skuadrën e Ilir Dajës. Partizani-Skënderbeu është kthyer në një epilog shumë përcaktues sezonet e fundit, një ndeshje shumë e ndërë edhe nga tifozëritë e të dy ekipeve. Kryeqytetasit luajnë përballë publikut të tyre dhe do të kërkojnë më çdo kusht të dalin me pikë të plota nga kjo sfidë, për shkak të atij fillimi sezoni më negativ në histori, Partizani është i detyruar t'i marrë maksimum çdo takim.

SERIE A

Interi 16 pikë larg Milanit, ja prej sa vitesh nuk

ndodhte kjo gjë Interi dhe Milani janë plot 16 pikë diferencë nga njëra-tjetra në renditje, pas 14 javësh kampionat. Një diferencë mjaft e madhe duke pasur parasysh shpenzimet e Milanit në merkato, përpara fillimit të sezonit. Megjithatë, skuadra e Spaletti ka arritur të jetë superiore duke u renditur në vendin e dytë me vetëm 2 pikë më pak se Napoli i vendit të parë. Në dhjetë vitet e fundit, asnjëherë Inter nuk ka pasur një avantazh të tillë ndaj Milan. Vetëm para 10 sezoneve (2007-2008), zikaltërit, që atëherë drejtoheshin nga Mancini, kishin një të tillë avantazh nga "kushërinjtë".

ANGLI

Siti nuk ndalet, përmbys Hadërsfilldin për suksesin e 12-të radhazi

Pas 11 fitoreve të marra resht në "Premier League", për pak u mendua se surpriza mund të vinte në ditën e djeshme. Hadërsfilldi ishte shumë pranë barazimit kundër kryesuesve të Mançester Sitit. Përpara këtij takimi vetë trajneri i ekipit të Hadërsfilldit, pohoi se të gjithë në jetë e kanë një shans, prandaj në ndeshjen e sotme ekipi i tij duhet të kapej fort pas tij. Kështu rezultoi, ekipi i Vagner jo vetëm që nuk iu dorëzua lehtësisht klubit të Guardiols, por e bëri atë të vuajë. Në fundin e pjesës së parë, do të ishte një autogol i Otamendit ai i cili do të dërgonte në dhomat e zhevshjes Mançester Sitin, me një disfatë. Në pjesën e dytë Siti iu kthye normalitetit duke shënuar menjëherë në fillimin e pjesës së dytë me anë të Agueros nga pika e bardhë. Kryesuesit do e gjenin veten në avantazh në këtë transfertë të vështirë, vetëm në minutën e 84 me anë të Sterling. Gjithsesi në fundin e ndeshjes Guardiola grumbullon 3 pikët e tjera, duke ruajtur në 8 pikë diferencën nga ndjekësit e tij.

KUPA E BOTËS



Qeveria e Perusë vendos, shanset për Italinë në Botëror marrin fund!

Pak ditë më parë, kudo në mediat botërore, qarkulloi lajmi se FIFA mund të pezullonte Perunë, për shkak të një projekt-ligji që ishte hartuar nga deputetja Paloma Nokeda, e cila e kalonte Federatën Peruane të Futbollit nën varësinë e Ministrisë Peruane të Sportit, gjë kjo rreptësisht e ndaluar nga organi më i lartë qeverisës i futbollit. Por, deputetja që shtroi këtë propozim, ka bërë një hap mbrapa dhe është tërhequr. Edhe pse pati deklaruar se projekt-ligji i saj nuk e dëmtonte aspak kombëtaren peruane, ajo ka zgjedhur të bëjë disa hapa pas, dhe të mos vërë në rrezik Perunë, duke hapur ndonjë çështje të padëshiruar në organet e FIFA-s. Kështu, Italia shuan një herë e përgjithmonë shpresat për të siguruar një vend në Botërorin e Rusisë.

Ramadani shkëlqen te Vejle, shënon golin e parë në Danimarkë

MESFUSHORI


Ylber Ramadani vazhdon të shkëlqejë me performancat e tij në Danimarkë. Pas golit të shënuar me Shpresat e Shqipërisë ndaj Irlandës së Veriut, Ramadani gjen golin e parë edhe me fanellën e Vejles. Ekipi i Vejles ka shkatërruar në fushën e saj Vendsyselin me rezultatin 4-1. Ekipi udhëtues ka arritur të kalojë i pari në avantazh, derisa Ylber Ramadani riktheu ekuilibrat në fushën e lojës në minutën e 14. Goli i mesfushorit të kombëtares shqiptare i hap rrugën ekipit të tij, për një fitore të thellë. Vejle nuk do ta diskutonte këtë takim, pasi e mbylli këtë ndeshje praktik-



isht që në pjesën e parë me rezultatin 3-1 ndërsa shënoi një gol tjetër në pjesën e dytë. Tashmë Vejle vazhdon të mbajë vendin e parë në kampionat, me tre pikë më

shumë sesa vendi i dytë. Objektivi kryesor i këtij ekipi, i cili drejtohet nga ish-tekniku i Partizanit, Sormani, është mbërritja në elitën e futbollit në Danimarkë.

Fjalëkryqi (1)




- HORIZONTAL**
1. Bëjnë arte me re.
 2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
 3. Janë forma.
 10. Në hyrje të plazhit.
 11. Kapen të parat.
 13. Janë ufot.
 14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
 18. Inicialet e Mascagnit.
 19. Në krye të trupave.
 20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
 22. Pak hemorragji.
 23. U shkrua nga Jack London.
 25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
 26. Scarlet e Bashkë me erën.
 27. Janë tituj në ekran.
 29. Eric aktor.
 31. Kështu e ka syrin vigjilent
 32. Janë nofka.
 35. Një provë... inteligjence.
 37. Mund të jenë me sahat.
 38. Një pjesë e navitetit.

- VERTIKAL**
1. Malet pa kufij.
 2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
 4. Inicialet e Altman.
 5. Një sportist që arrin majat
 6. Courier ish-kampion i tenisit.
 7. Fillojnë testin.
 8. Mund të jetë parabolike.
 9. Ëie me balie.
 10. Camera, ish-kampion i ringut.
 11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
 12. I kanë rrënjët në tokë.
 15. Eshhtë pushkë.
 16. Brown i Kodit Da Vinci-t.
 17. Takim Brezash Durrës.
 21. Ishite lumi i Elizit
 22. Eshhtë kardinal.
 24. Mbyllin një krah.
 28. Artikull anglez.
 30. Mbyllin fushatat.
 31. Partia pa ara.
 32. Zola që shkroi Nana
 33. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
 34. Një fjalë kastile
 36. Inicialet e Mann shkrimtar.
 39. Maiden që këndojnë.
 41. Ai i shtatë është kinemaja.
 43. Fillojnë arsyetimin.
 45. Eshhtë nënë e Tironës.
 46. Eshhtë shahu i fundit.
 48. Inicialet e Klee piktor.
 49. Dy asa.
 50. Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL:**
1. Patricia këngëtare.
 5. I vocërr ai i Migjenit
 9. Hari spiune.
 12. Qyteti i Robespierre.
 14. Phineas i famshëm i cirkut.
 16. Pak latinisht.
 17. Inicilet e Banderas.
 19. Janë tek në rrota.
 20. Pak efikasitet.
 22. Eshhtë shkolla filllore.
 24. Arrihet duke aderuar
 27. Pak iniciativë.
 28. Një... art i Don Judd.
 29. U kompozua nga Rachmaninov.
 31. Diku në qendër.
 32. Një është për të lidhur.
 33. Jepet për hartim.
 35. Sergej, poet i famshëm rus.
 37. Veriu pa kufij.
 39. Mbyllin një tender.


- VERTIKAL**
1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
 2. Eshhtë lloj papagalli.
 3. Një Pop i Andy Warhol.
 4. Sapo fillojnë.
 6. Qendër në Kubë.
 7. Eshhtë pluhuri si Dash.
 8. Eshhtë e hollë dhe therëse.
 9. Fillojnë muzikën.
 10. Një kontinent i ri.
 11. Eshhtë për medaljen e parë.
 13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
 15. Provinca e boerëve.
 18. Eshhtë qyteti i njëmbjnjë ditëare.
 21. Eshhtë dukuria.
 22. Eshhtë hidrokarbur.
 23. Griffith aktore.
 25. Qe perëndesha e fitores.
 26. Mbeten në fund.
 30. Tregon gmmimin.
 34. Këndohet në opera.
 36. Para Fe në New Mexico.
 37. Eshhtë princ arab.
 38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
 40. Bën mëza.
 45. Pak tolerante.
 47. Modem pa zë.
 48. Pak marramendëse.
 50. Mbyllin një dyqan.
 52. Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A R T E T K A M P U L A
R E A L C H E S T E
O R K P E R S N K N P
M T H E R R I M E T D I
A K U R E S M E R E T R O R
T U R H A M E S R E A
S E C T I L I N M O T E A
M A D A M E A K O M E T
I R O N I A T O M E T T
T I N A B L L O I S A M
E A H A L I L I S A M
T D I A N A A N T E N A

FJALËKRYQI (1)

P A K I G A P A L L A T E
R U D E R A H E R E T
O T L P R R P T I M O
V O L A M A T O R I P N
O R A S A T I R E T
K E V A S H A T B E L A
A T L N E K A R R A P
T A R I S E H A R K U
O R T A K E T H A R K U
R O Q E V E R I A N O T
R E M U T E M E Z E R O
T A P A N E L L Y Z E T I M

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 3 | | 8 | | | | | 2 |
| | | | | | 1 | 4 | 8 | 5 |
| | | 8 | 5 | 7 | | | | 6 |
| 4 | | | 8 | | 7 | 1 | | |
| 6 | | 2 | | 7 | | | | 4 |
| | 5 | 3 | | 1 | | | | 8 |
| | 7 | | | 2 | 4 | 5 | | |
| 3 | 1 | 6 | 9 | | | | | |
| 5 | | | | 3 | | 9 | 1 | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8 | 5 | 2 | 6 | 7 | 9 | 3 | 4 |
| 9 | 4 | 7 | 8 | 1 | 3 | 2 | 6 | 5 |
| 3 | 6 | 2 | 9 | 5 | 4 | 7 | 1 | 8 |
| 7 | 5 | 3 | 4 | 9 | 2 | 1 | 8 | 6 |
| 8 | 2 | 1 | 6 | 7 | 5 | 4 | 9 | 3 |
| 6 | 9 | 4 | 3 | 8 | 1 | 5 | 2 | 7 |
| 4 | 7 | 9 | 1 | 3 | 6 | 8 | 5 | 2 |
| 2 | 3 | 8 | 5 | 4 | 9 | 6 | 7 | 1 |
| 5 | 1 | 6 | 7 | 2 | 8 | 3 | 4 | 9 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Njohuritë mund të transmetohen, por jo zgjuarsia. (Herman Hese)
- Nata është nëna këshilluese. (Xhorxh Herbert)
- Njeriu i zgjuar dëgjon një fjalë dhe kupton dy. (Thënie hebraike)
- Një njeri i zgjuar përfiton më shumë nga armiqtë, se sa një budalla nga miqtë. (Baltazar Graciani)



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 4 | 1 | 9 | 2 | 10 | 19 | 6 | 5 | 4 | 5 | 3 | 19 |
| 6 | 4 | 1 | 3 | | H | | | 3 | T | 18 | 14 |
| 13 | | 4 | 3 | 2 | 4 | 3 | 2 | 4 | 5 | 3 | 18 |
| 7 | 2 | 9 | 5 | 4 | 6 | 5 | 4 | 5 | 3 | | 18 |
| 13 | 5 | 11 | 6 | 4 | 5 | 10 | 3 | 5 | 3 | 14 | 4 |
| 19 | | 3 | 2 | 16 | 1 | 4 | 2 | 3 | 2 | | |
| 7 | 4 | 6 | 14 | 5 | 2 | | | 1 | 11 | 5 | |
| 8 | 11 | 1 | 6 | 11 | 14 | | 4 | 2 | 18 | 11 | |
| 3 | 2 | 10 | 3 | 2 | 11 | 6 | | 18 | 4 | 4 | 2 |
| 18 | 8 | | 4 | | 5 | 7 | 6 | 14 | 6 | 3 | 5 |
| 15 | 2 | 3 | 2 | 11 | | 2 | 11 | 6 | 5 | 10 | 5 |
| 5 | 3 | 2 | 14 | 2 | 3 | | 7 | 2 | 3 | 5 | 3 |

E L E K T R I K K U R A
T E R R E N I K A N A L
I R M A F O N I K E
K A V I K T I M A T K
A M A R R E Z I T E S
M E T E O R I T E T A
R O M A N T I K E T Z N
E N E D A T T K O D
C I C E L A I K O N E
E T E R O L A Z A R
T O E A F A T A L
A R K I V A T D A K E T

- Vdekja e pyet Jetën: Pse ty të duan kaq shumë dhe më çmenduri, ndërsa mua më urrejnë?
- Jeta: Sepse une jam një gënjeshtrë e bukur, ndërsa ti je një realitet i hidhur.
- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.
- Mos iu drejto me ton të ashpër ndokujt. Atyre që do ju drejtohesh kështu mund të të përgjigjen në të njëjten mënyrë: plagët janë të dhimbshme; njëra pa tjetrës do bien mbi ty.

Thënie të mençura

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

